

**BISMIL'LAHI'R-RAHMANI'R-RAHIM**

**TEFEKKUR  
LIBRI MBI TË MENDUARIT**

**IMAM GAZALI**

**Prishtinë 2017**

*Ihjau Ulumid-din*  
Ringjallja e diturive fetare  
Imam Gazali

**Titulli i originalit**

*Kitâb'ul-Fikr*

Libri 39

**Përgatiti dhe përktheu**

Is-hak Shala dhe Abdullah B. Ferizi

**Lektor:**

Shenaj Zeneli

## ***Me emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëplotit!***

### **PARATHËNIE**

*Falënderimi (hamd) i takon vetëm Allahut, që nuk ka përcaktuar fundin e Madhështisë së Tij, e as kufi për epërsinë e Tij. Ai nuk ka fund. Forcat e perceptimit dhe logjikës nuk arrijnë të kuptojnë madhësitinë e Tij. Njohuritë, mendimet e inteligjenca nuk kanë arritur në esencën e Tij. Ata që mendojnë për Madhësitinë dhe Fuqinë e Tij, zemrat e tyre përmbysen në habi. Kur zemrat dëshirojnë ta kuptojnë Atë, nuri i Madhështisë së Tij i shtyp, e ato nuk arrijnë këtë hakikat. E kur zemrat kthehen në dëshpërim, nga perdet e Arshit u thuhet ‘durim, durim’, dhe ftohen të mos humbin shpresën.*

*Prandaj drejtoje mendimin në përulje dhe përshtatje urdhreve, sepse sado që të mendosh rreth (madhështisë së) Rububijetit, ti nuk mund të arrish as në një grimcë të Tij.*

*Nëse kërkon të mendosh diçka përtej cilësive tua, atëherë shiko mirësitë që Allahu Teala t’i ka dhuruar, si ato ndjekin njëra-tjetrën, mendo rreth tyre, dhe për çdonjë të veç e veç falëndero.*

*Mendo rreth oqeanit të caktimit (kader). Mendo mirë si rrjedh ai mbi botët: hairi-sherri, dobia-dëmi, vështirësia-lehtësimi, shpëtimi-humbja, kryelartësia-modestia, besimi-kufri, pranimi-mohimi.*

*Pra, mendo mbi cilësitë dhe veprat (ef'al) e Allahut Teala dhe kupto Madhështinë e Tij. Nëse kërkon që nga ef'ali të kolosh në kuptimin e Dhat-it, atëherë i ke hyrë një pune të zorshme, duke kaluar kufijtë e fuqisë tënde dhe duke munduar veten. Lëre kuptimin e Dhatit të Tij, sepse qysh në fillim mendjet habiten prej nurit të Tij, e detyrueshëm kthehen prapa.*

*Salat dhe selam qofshin mbi Muhammedin (a.s.), ai që edhe në kijamet do të bëhet i dobishëm për ne.*

*Salat dhe selam edhe mbi ehli bejtin dhe as'habët, çdonjëri prej tyre shkëlqen si yll, udhërrëfyes të myslimanëve.*

Tash dije se: një orë tefekkur<sup>1</sup>, është më e hairit se një vit ibadet. Kjo është shpjeguar me hadith dhe inkurajuar në Kur'an. Nuk ka dyshim që mendimi është çelësi i ndriçimit (nur) dhe filimi i basiretit<sup>2</sup>. Në saje të mendimit (tefekkur) arrihet aftësia e kuptimit, dituria dhe marifeti.

Shumica e njerëzve, edhe pse e ditën vlerën e lartë (fazilet) dhe rëndësinë e tefekkurit, nuk ditën hakikatin, frytin, burimin dhe rrugën e tij. Ata nuk kuptuan se ku dhe pse mendohet, ose çka është qëllimi i mendimit; a është qëllim vet mendimi apo janë frytet e të menduarit? Nëse qëllim i të menduarit janë frytet e tij, ku janë ato fryte? A është fryt dituria, apo gjendja, ose diçka tjetër që paraqitet nga bashkimi i këtyre të dyjave, apo të gjitha këto së bashku?

Shumica e njerëzve këtë nuk e kuptuan. E të kuptohen të gjitha këto është e rëndësishme. Prandaj, me lejen e Allahut, ne fillimisht do të shpjegojmë vlerën e lartë të tefekkurit, pastaj hakikatin dhe frytet dhe më pas edhe rrugën dhe vendin e mbledhjes së tij.

---

<sup>1</sup>**Tefekkur:** mendim; mendim i thellë; menduarje; meditim; konsideratë - mendim, gjykim a pikëpamje që kemi për dikë ose për diçka; reflektim.

<sup>2</sup>**Basiret:** mendjemprehtësi; largpamësi; syri i zemrës; të hetohet dhe kuptohet hakikati me zemër; të dihet hakikati i një sendi me zemër; fuqia e shenjtë (fuqia e Evliasë).



## KAPITULLI I PARË

### VLERA E LARTË (FAZILET) E TË MENDUARIT (TEFEKKUR)

Allahu Teala në disa ajete ka urdhëruar të menduarit, e me një ajet, duke lavdëruar ata që mendojnë thotë:

**“Për ata që Allahun e përmendin me përkujtim kur janë në këmbë, kur janë ulur, kur janë të shtrirë dhe thellohen në mendime rreth krijimit të qiejve e të tokës (duke thënë): Rabbi ynë, këtë nuk e krijove kot, i lartësuar qofsh, ruana prej dënimit të zjarrit.”**

3-Ali Imran: 191

Abdullah Ibn Abbasi r.a., tregon:

- *Disa njerëz filluan të mendojnë (mbi) Qenien e Allahut, e në këtë Resulallahu s.a.v.s., tha:*

**“Mos mendoni Qenien e Allahut Teala, mendoni (mbi) krijesat që Ai i ka krijuar, për shkak se ju nuk keni fuqi ta mendoni Qenien e Tij.”<sup>3</sup>**

---

<sup>3</sup> Ebu Nuajm në veprën *‘Hije’* si hadith *meruf*. E shënon edhe Isfahani në veprën *‘Tergib dhe Terhib’* nga transmetues të tjerë, e më i vërteti nga Ebu Nuajmi. Hadithin e shenojnë edhe Taberani në *‘Esvsad’* dhe Bejhakui në *‘Shuabu-l iman’* nga Ibn Omeri.

Një ditë, Resulallahu s.a.v.s, shkoi në një mbledhi të as'habëve. I pa ata në gjendje të mendimit dhe i pyeti pse nuk bisedojnë. Ata thanë që po mendojnë mbi krijesat e Allahut Teala, e Resulallahu s.a.v.s., ju tha:

**- Ashtu pra, mendoni mbi krijesat (e Tij), e jo Qenien e Allahut. Atje ku perëndon dielli është një krahinë e bardhë. Bardhësia e saj shkëlqen nur (dritë). Aty ekzistojnë krijesa të tilla të Allahut Teala, që për asnjë çast nuk kundërshtojnë urdhërat e Tij.**

Në pyetjen: *'A nuk kanë ata shejtanë?',* u përgjigj:

**- Ata as që e dinë që është krijuar shejtani.**

E në pyetjen *'A janë ata nga bijtë e Ademit?',* u përgjigj:

**- Ata as që e dinë që është krijuar Ademi.**

A t a tregon:

*- Një ditë unë dhe Ubejd b. Umejri shkuam në vizitë te Ajsha r.a., ajo bisedonte me neve pas perdes, e tha:*

*- O Ubejd, pse nuk na vjen në vizitë?*

*Ubejde tha:*

*- Më ndalon hadithi i Resulallahut s.a.v.s., kur thotë:*

**"Vizito herë pas here, që të shtohet muhabeti", dhe në vazhdim tha:**

*- Tregona ndonjë përjetim të habitshëm që ke përjetuar nga Resulallahu s.a.v.s..*



- Zaten çdo gjendje e tij ishte e habitshme, tha Ajsha duke qarë, dhe filloi të tregojë:

- Një natë kur ishte rendi te unë, Resulallahu s.a.v.s., hyri në shtratin tim. Kur trupi i tij preku trupin tim, tha:

- **Më lejo t'i bëj ibadet Rabbit tim.**

Morri enën me ujë, dhe ripërtëriu abdesin. Filloi të falej, me lot. Falte namazin dhe qante. Lotët ia kishin lagur mjekrën dhe vendin e sexhdes. Pastaj u mbështet në një anë, dhe ashtu mbeti deri sa erdhi Bilali për ezanin e sabahut. Kur Bilali e pa duke qarë, e pyeti:

- Pse po qan, kur dihet se Allahu Teala të ka falur gjynahet e kaluara, dhe të ardhurat. E ai tha:

- **Turp të kesh Bilal! Si mos të qajë, e më ka zbritur ky ajet:**

**“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendimtarët.”** (3-Al Imran: 190) dhe vazhdoi duke thënë:

- **Sa keq për atë që e lexon këtë ajet, e nuk thellohet në mendime.**<sup>4</sup>

Kur është pyetur Evzaiu:

- Çka është qëllimi i thellimit në mendime rreth këtij ajeti, Evzaiu u përgjigj:

- **Që duke lexuar, të kuptohet.**

---

<sup>4</sup> Ky hadith është përmendur në librin '**Sabr dhe shukur.**'

Muhammed b. Vasiu ka treguar:

- *Pas vdekjes së Ebu Dherit r.a., një person nga Basra shkoi në vizitë te nëna e Ebu Dherit r.a., e pyeti për ibadetin e të birit, e ajo iu përgjigj:*

- *Gjithë ditën ulej në një qoshe të dhomës dhe mendonte.*

Hasani Basriu ka thënë:

- *Një orë mendim (tefekkur) është më e hairit se sa tërë natën të bëhen ibadete nafile.*

Edhe Fudajl b. Ijadh ka thënë:

- *Tefekkuri është pasqyra jote, t'i tregon të mirat dhe të këqijat tua.*

Kur e kanë pyetur Ibrahim b. Ed'hemin:

- *Pse aq shumë po mendoni?* ka thënë:

- *Mendimi është mirësia e mendjes.*

Syfjan b. Ujejne r.a., shpesh citonte vargjet e poetit:

***'Kur thellohesh në mendim  
Nëçdo gjë gjen mësim.'***

Sipas tregimit të Tavus-it, Havaritët e pyetën Isanë a.s.:

- *O i Dërguari i Allahut, a ekziston dikush si ti, në këtë kohë e në këtë botë?* Isa a.s. përgjigjet:

- *Po. Fjala e tij është dhikër, heshtja e tij është mendim, shikimi i tij merr mësim. I tilli është sikur unë.*

Edhe Hasan Basriu ka thënë:

- *Të folurit që nuk ka hikmet, është boshllëk. Heshtja që nuk ka meditim, është gënjeshtër. Shikimi që nuk nxjerrë mësim, është dëfrim. E në tefsirin e ajetit:*

**“Do t’i largoj prej shenjave të Mia ata që sillen me arrogancë në Tokë.”** (7- A’raf: 146) ka thënë:” *Të tillëve do t’u pengohen zemrat nga mendimi rreth urdhrit Tim.”*

Në transmetimin e Ebu Said el-Hudrit, Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

- **Jepni syve tuaj atë që meritojnë nga ibadetet** (tuaja). Në pyetjen e tyre se çka janë ato, Resulallahu s.a.v.s., tha:

- **Ështëshikimi i Kur’anit; kur lexohet Kur’ani, të mendohet mbi ajetet dhe të merret mësim nga to.**

Llukmani rrinte vetëm e thellohej në mendime. Shokët i erdhën dhe i thanë:

- *Pse rrin vetë, a nuk është më mirë të shoqërohesh me njerëz?* Llukmani tha:

- *Vetmia është më e mirë për meditim. Meditimi e arrit njeriun në rrugën e xhenetit.*

Vehb b. Munebbih ka thënë:

- *Ai që mendon shumë, gjithsesi bëhet i ditur. E i dituri, gjithsesi edhe vepron.*

Omer b. Abdulazizi ka thënë:

- *Të mendohet mbi mirësitë (nimetet) e Allahut Teala, është nga ibadetet më të pëlqyera.*

Abdullah b. El-Mubareku një ditë e pa Shehl ibn Alinë në mendime dhe pyeti:

- *Ku arrite?* Shehli i tha:

- *Arrita në Sirat.*

Bishri ka thënë:

- *Po të mendonin njerëzit rreth madhështisë së Allahut Teala, nuk do të kundërshtonin urdhrat e Tij.*

Ibn Abbasi r.a., ka thënë:

- *Të falësh dy reqate duke menduar është më e hairit se sa tërë natën ibadet pa menduar.*

Ebu Shurej ishte duke ecur, përnjëherë u ul, e mbuloi fytyrën me shami dhe filloi të qajë. E pyetën:

- *Pse po qan?* Ebu Shurejri u përgjigj:

- *Mendova për të kaluarën dhe sa pak kam bërë vepra të mira, e vdekja u afrua.*

Ebu Suylejman ed- Deraniu ka thënë:

- *Mësojeni syrin të qajë dhe zemrën të mendojë.*

Gjithashtu Sylejmani ka thënë:

- *Mendimi për dynjallëkun është perde për ahiret dhe dënim për evlianë, kurse nga mendimi për ahiretin lind hikmeti dhe ringjallet zemra.*

Hatem el- Esami ka thënë:

- *Nga të menduarit shtohet frikë–respekti, nga nxjerrja e mësimit (me vrojtim) shtohet dituria, e me dhikër shtohet dashuria.*

Ibn Abbasi r.a., ka thënë:

- *Mendimi i hairit e fton hairin, e pendimi për të keqen fton në largim prej saj.*

Sipas transmetimit, në njërin nga librat e zbritura nga Allahu Teala është thënë:

*“Unë nuk pranoj çdo fjalë të mendimtarit; por shikoj dëshirën dhe qëllimin e tij. Nëse dëshira dhe qëllimi është për Mua, atëherë pranoj edhe heshtjen e tij, mendimin e tij dhe falënderimin (hamd) e tij.”*

Hasan Basriu ka thënë:

*- Të mençurit, përmes dhikrit vazhdimisht kthehen në mendime, e me mendime kthehen në dhikër, deri sa zemra t’ju flet hikmet (dituri).*

Is’hak b. Hafiu tregon:

*- Një natë, Davud Tai ishte në çati, nën ndriçimin e hënës, duke menduar rreth fshehtësive të qiellit. Deri sa po shikonte qiellin e qante, rrëshqet e bie në oborrin e komshiut. Komshiu u ngrit nga shtrati, dhe duke menduar që është hajni morri shpatën, e kur e pa Davud Tain e ktheu shpatën në vend, dhe e pyeti:*

*- Kush të hodhi nga çatia? Davud Taiu tha:*

*- Asgjë nuk di!*

Xhuneid Bagdadi ka thënë:

*- Mexhliet (tubimet) më të ndershme janë mexhliet e atyre që mendojnë në tevhid, që mbajnë erë të marifetit, pinë me gotën e dashurisë nga deti i dashurisë dhe me dëshirë të mirë mendojnë për Allahun Teala. Myzhde për ata që qëndrojnë në mesin e tyre dhe pinë nga deti i dashurisë.*

Edhe Imam Shafiu ka thënë:

*- Kërkoni ndihmë nga heshtja dhe nga nxjerrja e kuptimit prej mendimit.*

Përsëri Imam Shafiu:

*- Shpëtim nga mashtrimi është mendimi i shëndoshë për gjërat, e shpëtim nga mosangazhimi, si edhe pendim është mendimi me vendosmëri. Të menduarit racional dhe ideja nxerrin mendim të drejtë dhe zgjuarësi. Këshillimi me të mençurit siguron qetësinë shpirtërore dhe forcën e largpamësisë. Para vendimit, mendo. Para se të sulmosh, llogarit përfundimin. Para se të fillosh punën, këshillohu.*

Gjithashtu Imami ka thënë:

*- Vlera të larta janë katër: e para është hikmeti, e shtylla e saj është tefekkuri (mendimi). E dyta është ndershmëria, e që është drejtëpeshimi i epshit (grada e përkryer e epshit). E treta është trimëria, që është drejtëpeshimi i zemërimit (grada e përkryer e zemërimit). Dhe e katërta është drejtësia, e qëndrueshmëria e saj është matura dhe drejtëpeshimi i fuqisë së nefsit.*

Pra, këto janë fjalët e dijetarëve rreth mendimit (tefekkur). Por asnjëri nuk shpjegoi hakikatin e mendimit dhe mënyrat e të menduarit.

## KAPITULLI I DYTË

### HAKIKATI DHE FRYTET E MENDIMIT

Dije se: tefekkur (mendim) do të thotë takimi i dy marifeteve<sup>5</sup> në zemër, për të lindur marifeti i tretë. Shembull: nëse dikush anon kah dynjallëku, por dëshiron të dijë se si është më mirë t'i jepet përparësi ahiretit, ka dy mënyra për të arritur këtë:

E para është që, duke dëgjuar nga të tjerët se ahireti është më i vlefshëm se sa dynjaja, i imiton ata pa hyrë në thellësi të çështjeve, anon kah ata dhe, duke besuar në fjalët e tyre, vepron ashtu siç e kërkon preferimi i ahiretit, por kësaj i thuhet imitim, e jo marifet.

Rruga e dytë është që ta dijë se preferimi i të përhershmes është më i vlefshëm se sa preferimi i të përkohshmes, dhe ta dijë që ahireti është i përhershëm. Nga këto dy marifete lind një marifet i tretë. E ajo është dituria që preferimi i ahiretit është më i vlefshëm. Domethënë që marifeti i tretë përfitohet vetëm me anë të dy marifeteve të para. Përgaditjes së dy marifeteve në zemër për të arritur marifetin e tretë, i jepet emërtimi *tefekkur* (mendim), *itibar* (konsideratë), *tezekkur* (përkujtim), *nazar*

---

<sup>5</sup>**Marifet:** njohuri; dituri; dituri që fitohet me mendim; njohja e vërtetës; ta njohësh Hakkun; talent; aftësi; zotësi; mjeshtri.

(vështrim), *teemmul* (të menduarit për detajet) dhe *tedebbur* (të menduarit e rezultatit). *Tedebbur*, *tefekkur* dhe *teemmul* janë fjalë të ndryshme me një kuptim të përbashkët – të mendohet mirë. Por *itibar*, *tezekkur* dhe *nazar*, sado që janë një nga pikëpamja e emërtimit, kuptimet i kanë të ndryshme. Kështu, sado që me fjalët *sarim* (prerës), *muhenned* (shpatë nga hekuri Indus) dhe *sejf* (shpatë) flitet rreth një sendi të njëjtë, ato janë të ndryshme. Të gjitha janë shpata, por *sarim* quhet shpata për shkak të prerjes që e bën, *muhenned* tregon lidhjen e asaj shpate me Indinë si vend i origjinës së saj, ndërsa *sejf* është emërtim absolut, nuk tregon as vendin e prejardhjes e as mënyrën e prerjes, por tregon vetëm për shpatën.

Edhe me *itibar* (konsideratë) dhe *ibret* (mësim që nxirret nga një veprim) është kështu. Pra, dy marifetet e para janë përgaditje për të përfutuar marifetin e tretë. Nëse nga dy marifetet e para nuk mundet të kalohet në marifetin e tretë, dhe nuk mund të arrihet rezultat, kësaj nuk i thuhet *itibar* dhe *ibret*, por *tezekkur*. Kërkesa për marifetin e tretë quhet *nazar* dhe *tefekkur*. Atij që nuk kërkon marifetin e tretë nuk i thuhet ‘*nazër*’ (vëzhgues), e as nuk quhet mendimtar. Çdo *mutefekkir*<sup>6</sup> është *mutezekkir*<sup>7</sup> por çdo *mutezekkir* nuk është

---

<sup>6</sup>Mutefekkir:menduar; mendueshëm

<sup>7</sup>Mutezekkir: kujton; bisedon rreth një problemi; përmend.



*mutefekkir*. Ku ka *tefekkur* ka edhe *tezekkur*<sup>8</sup>, por ku ka *tezekkur*, *tefekkur* mund edhe të mos ketë. Dobia e *tezekkurit* është që marifeti vendoset në zemër, që të mos fshihet nga aty dhe të përkujtohet. E dobia e *tefekkurit* është shtimi i diturisë nga dy marifetet e para, duke sjell marifetin e tretë, i cili nuk është ende prezent. Ja, ky është dallimi në mes të *tezekkurit* dhe *tefekkurit*.

Kur marifetet mblidhen në zemër dhe radhiten aty sipas një rregulli të veçantë, si fryt lind një marifet tjetër. Domethënë marifeti lind marifetin. E kur lind një marifet i ri, dhe ky marifet bashkohet me një marifet tjetër, prapë lind edhe një marifet. Në këtë mënyrë, marifetet ndjekin njëri-tjetër. Tefekkuri vazhdon, e marifetet shtohen pa ndalë. Shtimi i marifetit ndërpritet nga ndonjë pengesë, ose me vdekje. Vetëm ai që është i aftë, duke i shfrytëzuar dituritë, hyn në rrugën e *tefekkurit*. Shumica e njerëzve janë të varfër nga më shumë dituri për shkak të humbjes së kapitalit kryesor. Ai kapital është marifeti që lind dituri. E pa kapital nuk ka fitim. Si në tregti, dikush edhe mund të ketë kapital, por nëse nuk ka aftësi, mund edhe të mos fitojë. Njëjtë, dikush edhe posedon marifetin - që është kapitali kryesor i diturisë, por nuk di të çiftëzojë marifetet, prandaj nuk mund të marrë fryt.

---

<sup>8</sup> *Tezekkur*: bisedë (rreth një problemi); sjellje në kujtesë (e një problemi); përkujtoj.

Këto marifetenganjëherë përdoren përmes një nuri *fitri* (të lindur), të cilin Allahu Teala e ka vendosur në zemra, dhe kjo është mënyra më e zakonshme. Nganjëherë, te personi i cili mendon mund të gjindet edhe marifeti, e te këta lindin edhe frytet, por ai nuk di se si këto fryte dalin në shesh, meqenëse nuk posedonaftësinë e shprehjes dhe nuk mund ta shpjegojë. Shumica e dinë sigurtë që është më e hairit të synohet ahireti, por kur pyeten për shkakun e këtij marifeti, nuk mund ta shpjegojnë. Ndërsa, ky marifet ka lindur nga dy marifetet e mëparshme: pra duke e ditur që ahireti është i përhershëm dhe me preferimin e të përhershmes karshi të përkohshmes.

Frytet e mendimit (tefekkur) janë dituria, gjendja dhe veprimi. Dituria është fryt i veçantë, sepse kur paraqitet dituria në zemër, gjendja e zezës ndryshon. Duke ndryshuar gjendja e zezës ndryshojnë edhe veprimet e gjymtyrëve. Pra vepra është e lidhur me gjendjen, gjendja me diturinë e dituria me tefekkur. Kjo do të thotë që fillimi dhe baza e të gjitha mirësive është tefekuri. Ja, kështu ty haptas të zbulohet vlera e lartë e tefekurit. Tefekuri është më i hairit se dhikri. Sepse tefekuri nënkupton edhe dhikër, bile është më shumë se dhikri. Dhikri i zezës është më i hairit se sa veprat e gjymtyrëve tjera. Vlera e veprës është në saje të dhikrit, e pasi mendimi (tefekkur) është mbi dhikrin, ai është edhe mbi të gjitha veprimet tjera. Për këtë arsye është thënë: *'më e hairit është një orë mendim (tefekkur) se sa një vit ibadet.'*

Gjithashtu thuhet që mendimi largon njeriun nga gjërat e palavdërueshme në të lëvdueshme, nga zilia (e kësaj bote) dhe pangopësia, në maturi dhe modesti. Thuhet edhe që mendimi nxit në soditje shpirtërore dhe devotshmëri (*takva*).

Për këtë Allahu Teala thotë:

**“...dhe i kemi shpjeguar paralajmërimet, që ata t’ua vënë veshin.”** 20-Ta Ha: 113

Puna e ahiretit që shpjeguar më lartë është shembull i mirë për të kuptuar ndryshimin e gjendjes me mendim. Sepse mendimi na njofton që ahireti meriton preferimin. Kur ky marifet vendoset sigurt në zemrat tona, ato zemra që më përpara kanë dashuruar dynjanë, ia kthejnë shpinën asaj dhe fillojnë të orientohen kah ahireti. Ja, këtë e synojmë kur flasim për ndryshimin e gjendjes. Para këtij marifeti, zemra ndjente urrejtje ndaj ahiretit dhe dashuronte dynjanë. Pas këtij marifeti, gjendja e zemrës ndryshon. Ndryshon vullneti dhe kërkesa. Ndryshimi i vullnetit shfaq ndikimin edhe mbi gjymtyrë, dhe personi, duke e braktisur dynjanë, punon për ahiret. Këtu ekzistojnë pesë grada:

Grada e parë: *tezekkur* (sjellje në kujtesë); përgatitja e dy marifeteve në zemër.

Grada e dytë: *tefekkur* (meditim); me qëllim që nga këto dy marifete, të kërkohet marifeti i tretë.

Grada e tretë: ndriçimi i zemrës me shfaqjen e marifetit të tretë të kërkuar.

Grada e katërt: ndryshimi i gjendjes së zemrës me ndihmën e këtij marifeti të tretë.

Grada e pestë: hyzmeti i gjymtyrëve përshtatshëm gjendjes së re të zemrës.

Siç paraqitet në terr drita kur hekuri godet gurin e çakmakut, e me këtë ndriçon hapësirën afër vetes dhe stimulon organet për veprim, ashtu edhe mendimi është çakmak i dritës së marifetit. Bashkimi i gurit dhe hekurit, e më pas goditja e hekurit në gurin e çakmakut në një mënyrë të caktuar bën që të paraqitet drita, e me këtë ndryshon gjendja e syrit dhe ai arrin të shohë. Njëjtë sikur dy marifete kur vendosen në zemër në mënyrë të caktuar, e nga këto dy marifete lind dritë (nur), me çka ndryshon gjendja e zemrës. Ashtu siç nxiten gjymtyrët në veprim kur syri të shohë pas paraqitjes së dritës nga çakmaku, njëjtë gjymtyrët fillojnë të veprojnë me gjendjen e re të zemrës, dhe sipas saj bëjnë ibadet.

Domethënë, fryt i mendimit është dituria dhe gjendja. Siç nuk ka fund dituria, as gjendjet që ndryshojnë në zemër nuk mund të numërohen. Për këtë, nëse muridi dëshiron të sqarojë dhe numërojë mendimet e shumëllojshme dhe rrugët (rrjedhjet) e tyre, nuk ia del. Rrjedhjet e mendimit nuk mund të numërohen, dhe frytet e tyre janë pa fund. Prandaj, ne do të përpiqemi t'i përshkruajmë këto rrjedhje (rrugë) të mendimit në lidhje me veprimet e rëndësishme të fesë, dhe në lidhje me gjendjet e udhëtarit shpirtëror (salik), teksa kalon nga grada në gradë. Aq më shumë, ky përshkrim është vetëm një përmbledhje e shkurtër, sepse hyrja në hollësira do të kërkonte shpjegimin e plotë të të gjitha diturive. Të gjitha këto libra (Ihja Ulumid-din) e shpjegojnë njëra-tjetrën. Ato përfshijnë dituritë që paraqiten nga mendime të posaçme. Ne po tregojmë mesataren e përbashkët të tyre, që t'i bëjmë të njohura rrjedhjet (rrugët) e mendimit.

## KAPITULLI I TRETË

### RRUGËT E MENDIMIT

Dije se, mendimi nganjëherë rrjedhë në lidhje me çështjet e fesë, e nganjëherë me ato çështje që nuk kanë lidhje me fe. Qëllimi ynë janë rrjedhjet (rrugët) në lidhje me fenë. E me fe - mendojmë në lidhjen e robit me Rabbin e vet.

Të gjitha mendimet e njeriut janë në lidhje me veten, cilësitë dhe gjendjet e tij, ose me Atë që adhuron - Allahun, cilësitë dhe veprat e Tij. Nuk ka mundësi të dalë jashtë nga këto dy korniza. Mendimet në lidhje me veten janë për gjërat që janë të dashura tek Allahu Teala, dhe për ato që nuk janë të dashura tek Ai. Zaten, jashtë këtyre dy pjesëve nuk ka nevojë për mendim. Mendimet e lidhura me Allahun mund të jenë mendimi i Dhatit (Qenies) të Allahut Teala, cilësitë dhe emrat e bukur të Allahut Teala (Esmā-i Husna), ose janë të lidhura me veprimin (ef'al), përcaktimin, dhe me çdo gjë që ekziston, në qiell e në tokë, dhe në mes tyre.

Gjendja e atij që drejtohet dhe dëshiron të arrijë knaqësinë e Allahut i përngjanë gjendjes së të dashuruarve. Ta shqyrtojmë pra të dashuruarin e zjarrtë:

Padyshim që të gjitha mendimet e të dashuruarit janë për atë që do dhe për vete. I dashuruari mendon atë që do për të marrë kënaqësi duke shikuar bukuritë e qenies së të dashurit, ose mendon natyrën e mirë, virtytet dhe veprat e mira që janë shpjegues të cilësive të të dashurit, për të shtuar edhe më shumë dashurinë dhe kënaqësinë.

E kur mendon për vete, mendon për cilësitë që nuk janë të pëlqyera për atë që do, cilësi këto që largojnë nga personi i dashur, ose - mendon që të stoliset me cilësitë që e afrojnë te personi i dashur. Nëse mendon diçka tjetër nga këto, me këtë tejkalon kufirin e dashurisë, që është mangësi në dashuri. Sepse në kuptimin e plotë, dashuria nuk lë vend për tjetrin në zemër të të dashuruarit. Personi që e do Allahun është i tillë; asnjë mendim i tij të nuk mund të jetë jashtë dashurisë. E ai që është i preokupuar me mendime për këto katër gjëra që i përshkruam më lartë, nuk del jashtë përkufizimit të muhabetit (dashurisë).

## PJESA E PARË

Tani të marrim në shqyrtim pjesën e parë - mendimi i cilësive dhe veprimeve të veta. Pra, kjo pjesë ka të bëjë me diturinë praktike (*muamele*), që është qëllim i këtij libri. Pjesa tjetër është në lidhje me diturinë *mukashefe*.

Veprat e personit ndahen në dy: në ato që janë të pëlqyera tek Allahu Teala, dhe në ato që nuk janë të pëlqyera tek Ai.

Një pjesë nga këto janë *zahir* (të jashtme), e që janë veprime të gjymtyrëve - kryengritja dhe nënshtrimi.

Pjesa tjetër është *batin* (e fshehtë); që janë cilësi të shpëtimit dhe dëmtimit, e vendi i tyre është në zemër. Kjo pjesë e batinit është shpjeguar në librat '*Rub'ul-Munxhijat'* dhe '*Muhlikat'*.

Nënshtirimi dhe kryengritja ndahen në dy: në secilën prej shtatë gjymtyrëve, dhe në tërë trupin (siç janë ikja nga fushëbeteja, kryengritja ndaj prindërve dhe qëndrimi në vende të haramit).

Është obligim (*vaxhib*) që për secilën nga këto të mendohet në tri çështje:

1. Të mendohen gjërat që janë të papëlqyeshme (*mekruh*) tek Allahu Teala, dhe ato që nuk janë mekruh tek Ai. Ka mekruhë të tillë që, pas një mendimi të hollësishëm, kuptohen.

2. Pasi që kuptohet se diçka është mekruh, duhet të mendohet zgjidhja se si të mbrohet nga kjo.

3. Besimtari duhet të mendojë nëse është i zënë tani me këtë mekruh dhe ta braktis menjëherë, ose ekziston mundësia që në të ardhmen ndeshet me atë mekruh e sipas kësaj merr masa mbrojtëse, ose është për të kaluarën dhe të kompenzojë.

Ky mendim i trefishtë vlen edhe për secilën prej gjërave të pëlqyera, që njëjtë ndahen si gjërat mekruh. Kur mblidhen të gjitha këto së bashku, çilen mbi njëqind rrugë të mendimit. Personit i është lënë të mendojë për të gjitha këto, ose një pjesë të tyre. Të flitet për secilën veç e veç, fjala zgjatet shumë. Por në esencë, këto kufizohen në katër: kryengritje, nënshtirim, shkatërrim dhe shpëtim. Për secilën prej tyre do të japim shembuj, që besimtari t'i krahasojë me të tjerat, e me këtë t'i çelet dera e mendimit dhe t'i zgjerohet rruga.

**Lloji i parë** është kryengritja. Njeriut i ka hije dhe i përshtatet që çdo ditë në mëngjes të ekzaminojë hollësisht të shtatë gjymtyrët e pastaj të mendojë mbi tërë trupin. Nëse tani është duke bërë

gjynah me një gjymtyrë ose me tërë trupin, menjëherë atë ta braktisë, nëse ka ndonjë gjynah që është bërë dje, duhet të pendohet dhe të bëjë teube, e nëse ka mundësi për të bërë ndonjë gjynah gjatë ditës, duhet të merr masa, për t'u mbrojtur dhe larguar.

Fillimisht duhet tërhequr vëmendja gjuhës; duhet të mendojë se si gënjeshtër, përgojimi, shpifja, tallja, lavdërimi i vetes, armiqësia, fjalët boshe dhe të ngjashmet, janë fjalë (sjellje) të papëlqyera tek Allahu. Duhet të përkujtojë tërheqjen e vëmendjes për to në Kur'an dhe sunnet, pastaj se si mund të bie në këto rreziqe, bile edhe pa dashje. Madje, duhet të kuptojë që zgjidhja për t'u mbrojtur nga këto është në largimin prej njerëzvedhe në shoqërimin me persona të sinqertë e të devotshëm, të cilët do ta paralajmërojnë çdoherë kur të flet fjalë të papëlqyera. Nëse për këtë nuk ka mundësi, le të vendos guralec në gojë për ta paralajmëruar kur dëshiron të flasë. Kështu janë zgjidhjet për të shpëtuar nga gjuha (fjalët e papëlqyera).

Më pas duhet t'i përkushtojë vëmendje veshit; të mendojë që mund të dëgjojë gënjeshtër, përgojim, fjalë boshe dhe bidate, nga Mehmedi, Veliu a persona të tjerë. Ose duhet të largohet, ose të ruhet duke ndaluar përdorimin e këtyre fjalëve të papëlqyera.

Tani t'i përkushtojmë vëmendjen stomakut. Kryengritja e stomakut bëhet me ngrënie dhe pije. Ose ha shumë nga hallalli, e kjo është mekruh (e papëlqyer) tek Allahu sepse e forcon epshin, që është armë e shejtanit, ose kryengritja bëhet me ngrënie



haram, ose me kafshatë të dyshimtë. Duhet të kujdeset si fiton ushqimin, veshjen dhe shtëpinë, duhet të hulumtojë a është apo s'është hallall, haram ose e dyshimtë. E pastaj duhet të mendojë zgjidhjen për largim nga harami dhe të mendojë se si nuk do të pranohen ibadetet e bëra me kafshatë haram. Ta dijë domosdo që kafshata hallall është themeli i ibadeteve. E nëse gjendet edhe një cent në blerjen e rrobave me të cilat falë namazin, ai namaz nuk do të pranohet. Kjo na është lajmëruar në transmetime.

Kështu duhet të mendojë për tërë gjymtyrët e trupit. Kur me mendim arrihet marifeti i vërtetë i këtyre gjendjeve, atëherë e kaplon vetëkontrolli (*murakabe*), për të mbrojtur organet nga gjynahet gjatë gjithë ditës.

**Lloji i dytë** është përshtatja ndaj urdhërave (*taat*). Së pari nuk duhet të braktis farzet, duhet të mendojë a po i zbaton këto në kohë dhe pa mangësi, a po i plotëson mangësitë e farzeve me nafile. Pastaj duhet t'i drejtohet secilës gjymtyrë veçeveç, dhe të mendojë për veprimet e dashura tek Allahu Teala, të lidhura për çdo gjymtyrë. Të marrim shembull syrin: duhet ta dijë që syri është krijuar për të marrë mësim nga shikimi i qiejve dhe tokës, për të shikuar Kur'anin dhe sunnetin, për ta përdorur në përshtatje ndaj urdhërave, dhe duhet të thotë:

*“Pse nuk po e përdori syrin për këto kur e kam atë fuqi?”*, dhe gjithashtu duhet të thotë:

*“Kur mundem, pse nuk shikoj me nder personin e devotshëm e ai me këtë gëzohet; e të shikoj me përbuzje personin gjynahqar e me këtë ai largohet nga gjynahet.”*

Njëjtë duhet t'i thotë veshit:

*“Kur mundem, pse nuk dëgjoj fjalë të përmallshme, fjalë që kërkojnë ndihmë, urtësi dhe dituri, të dëgjoj Kur'anin dhe dhikrin?”* Duhet të thotë:

*“Allahu Teala më dhuroi nga mirësitë e Veta veshët, e si të mos e falënderoj? Pse këtë mirësi (dhuratë) nuk e përdori në përputhje me sheriat?”*

Edhe për gjuhë duhet kështu të mendojë, e të thotë:

*“Pasi kam mundësinë të pyes për gjendjen e të varfërve, të gëzoj zemrat e të mirëve, të këshilloj, të jap mësim dhe ngjashëm, pse nuk veproj kështu? Fjala e mirë është sadaka për njeriun.”*

Njëjtë si kjo duhet të mendojë edhe për pasuri, e të thotë:

*“Tani për këtë pasuri nuk kam nevojë, mund ta jap sadaka. Nëse bëhëm nevojtar, Allahu më jep. Edhe nëse kam unë nevojë në këtë çast, duhet t'i jap përparësi atij që ka më shumë nevojë për të; unë kam nevojë më shumë për sevap, dhe duhet të jap.”*

Për tërë trupin, gjymtyrët dhe pasurinë duhet kështu të mendojë. Të gjitha ato janë në një mënyrë mjet dhe shkak për zbatimin e urdhrave të Allahut Teala, për të adhuruar Allahun. Duhet që me mendim të kërkojë rrugët për zbatimin e urdhrave të Allahut Teala dhe të mendojë se çka e shtyen në nënshtrim. Duhet të shqyrtojë nijetin (qëllimin) në zbatimin e urdhrave të Allahut Teala.

**Lloji i tretë** janë cilësitë e rrezikshme që arrijnë në zemër. Ato janë epshi, zemërimi, koprracia, mburrja, dyfytërsia, xhelozia, zilia, dëshirimi i së

keqes, pakujdesia, arroganca dhe të ngjashme, e këto mësohen në vëllimin e tretë të librit *'Ihjaw Ulumid-din', 'Ru'u'l-Muhlikat'* (Veprimet shkatërruese). Zemra duhet të hulumtohet; nëse pandeh që zemra është larg nga këto sëmundje, për ta testuar, duhet të mendojë. Sepse nefsi vazhdimisht premtan mirësi, por nuk e mban fjalën. Për shembull, nëse personi pohon që nuk mburret por është modest, le ta testojë veten duke u ngarkuar me dru në shpinë dhe le t'i bartë për në shtëpi. Kështu kanë vepruar të parët. Nëse pohon që është i butë, le ta testojë se a do të ketë sjellje të buta kur dikush e zemëron. Edhe me cilësitë tjera le ta testojë veten.

Kjo është provë që dëshmon nëse je apo nuk je i prirur për vese të këqija. Gjurmët e kësaj u shpjeguan në vëllimin *'Rub'u'l-Muhlikat'*. Nëse gjurmët dëshmojnë ekzistimin e këtyre veprimeve shkatërruese, atëherë duhet të mendohet për shkaqet e tyre dhe do të bëhet e qartë që burim është padituria (xhehalet), pavëmendshëmëria (gaflet) dhe papastërtia e brendshme. Për shembull, kur i pëlqen veprimet vetjake, duhet të mendojë e të thotë:

*"Ai m'i ka krijuar edhe gjymtyrët, edhe mundësinë, e edhe dëshirën për ta kryer këtë vepër. Nëse një njeri nuk mund as të qëndrojë vetëvetiu, si mundet që t'i pëlqejë veprimi i vet?"*

Kur në vete zbulon sëmundjen e mendjemadhësisë, duhet ta pranojë që kjo vjen nga injoranca e vet, dhe të thotë:

*"Pse po mendon që je më i mirë se të tjerët? I mirë është ai që tek Allahu është i mirë, e kjo kuptohet vetëm pas vdekjes. Ka shumë njerëz që*

*llogariten si qafirë e mund të vdesin si besimtarë, dhe ka shumë besimtarë, që vdesin si qafirë."*

Kështu, kur e kupton që mendjemadhësia është sëmundje e rrezikshme që vjen nga injoranca, dëshiron ta zhdukë atë dhe mundohet të bëhet modest.

Kur gjen në vete dëshirën për të ngrënë më tepër, duhet të mendojë që ky është veprim i shtazëve. Ngrënia e tepërt dhe marrëdhëniet e tepërta seksuale nuk paraqesin përkryerje, por janë cilësi të shtazëve.

Edhe për cilësinë e zemërimit duhet të mendojë kështu, dhe pastaj të kërkojë zgjidhjen për përmirësim. Të gjitha këto i shpjeguar në këtë libër (*Ihja*). Ai që dëshiron të zgjerojë rrugën e mendimit (*tefekkur*) duhet t'i lexojë këto libra.

**Lloji i katërt** janë gjërat që shpëtojnë (*munxhijat*), e ato janë teubeja, pendimi nga gjynahet e bëra (*nedamet*), durimi në fatkeqësi, falënderimi për mirësitë, frika dhe shpresa, sinqeriteti në veprim, pëlqimi për caktimin e Tij, dashuria ndaj Allahut, përmallimi, përulja dhe modestia (ndaj Tij).

Të gjitha këto i shpjeguar në këtë vëllim, të katërtin me radhë. Bile, nuk u mjaftuar me shpjegime por i treguar edhe shkaqet e tyre. Njeriu duhet çdo ditë të mendojë për zemrën e vet - çka është ajo që i mungon nga cilësitë që afrojnë te Allahu Teala. Do ta kuptojë që ato cilësi në të vërtetë janë gjendjet që janë fryt i diturisë, e dituritë janë fryt i mendimit.

Shembull, kur dëshiron të përfitojë nga gjendjet e pendimit, fillimisht duhet të shikojë gjynahet të veta, të mendojë rreth tyre, t'i vlerësojë të gjitha, dhe ta kuptojë që janë gjynahe të mëdha. Duhet të mendojë premtimet e vuajtjes për to, dhe të mendojë se qysh tani po e vuan dënimin Hyjnor, e në saje të këtyre mendimeve të pendohet për të bëmat.

Kur dëshiron të përfitojë gjendjen e falënderimit (shykyr) në zemër, le të mendojë dhuratat dhe mirësitë e Allahut Teala ndaj tij dhe si Allahu ia fsheh mangësitë.

Kur dëshiron të stoliset me gjendjen e dashurisë (*muhabet*) dhe përmallimit, le të mendojë Madhëstjinë (*Xhelal*), Bukurinë (*Xhemal*), Madhësinë (*Azama*) dhe Lartësinë (*Kibria*) e Allahut Teala. Kjo është e mundur duke menduar veprat e bukura të Tij, që mahnisin mendjet. Këtë do ta shpjegojmë më shumë në pjesën e dytë të këtij kapitulli.

Kur dëshiron gjendjen e frikërespektit (*havgf*) le të mendojë fillimisht gjynahet e tij të jashtme (*zahir*) dhe të brendshme (*batin*), që do të pyetet për të gjitha gjynahet veç e veç, pastaj le të mendojë gjendjen e vdekjes, pyetjet e melekëve Munkir dhe Nekir, vuajtjen në varr, krimbat, gjarpërinjtë dhe akrepat, fryerjen në Sur dhe momentin e tmerrshëm, ringjalljen pas vdekjes dhe tubimim për llogari, që llogaria do të jepet edhe për veprat sa një thërmijë, matjen e veprave në mizan (peshorja), që libri i dhënë nga e djathta është për xhenetlinjtë e libri i dhënë nga e majta për xhehenemlinjtë, hollësinë dhe mprehtësinë e Siratit, dhe duke i menduar këto - ta zgjojë frikërespektin. Pastaj le të gjallëroj në vete xhehenemin dhe shtresat e tij, vuajtet e

shumëllojshme, fytyrën e shëmtuar të zebanit - rojeve të xhehenemit, dhe se si trupi që digjet rikrijohet përsëri, kthehet në gjendje të mëparshme dhe dënimi vazhdon nga e para. Kështu le të vazhdojë pandërprerë, dhe duke i mendar gjendjet e tilla, të frikësohet.

E kur dëshiron të përfitojë gjendjen e shpresës, lë të mendojë dhe ta përforcojë shpresën duke përkujtuar xhenetin, mirësitë e llojllojshme të xhenetit, pemët dhe lumenjtë, hyritë dhe gilmanët, dhe mirësitë e pafund.

Për të përfituar gjendjet e pëlqyeshme duhet dituri. Me dituri përfitohen cilësitë e dëshirueshme dhe largohet nga cilësitë e këqija; kjo është rruga e mendimit. Secilës ia kushtuam nga një libër të veçantë. Leximi i tyre ndihmon në mendim të hollësishëm. Nëse dëshirojmë t'i gjejmë të gjitha në një vend, nuk ka më të mirë se Kur'anin Kerim, që lexohet duke menduar mbi kuptimin. Kur'ani i përfshinë të gjitha gjendjet dhe gradat. Aty është shërimi. Aty është shpjeguar gjendja e frikërespektit (*havf*), shpresës (*rexha*), durimit (*sabr*), falënderimit (*shykyr*), muhabetit (*dashuri*), dëshirës së zjarrtë (*shevk*) dhe gjendjet tjera. Edhe ndalimi i cilësive të këqija është aty. Njeriuti takon të lexojë Kur'anin, dhe ajetin që e ka lexuar e për të cilin mendon, t'i kthehet dhe ta përsërisë, qoftë edhe njëqind herë. Një ajet që lexohet duke menduar është më i vlefshëm se një hatme (leximi i tërë Kur'anit). Bile, për një ajet duhet të mendojë së paku një natë të tërë. Sepse në çdo germë të Kur'anit fshihen me mijëra sekrete, dhe këto mund të përfitohen vetëm pas mendimit të hollë, që vjen nga zemra e pastër,

pas veprimeve të drejta. Kështu duhet të lexohen edhe hadithet e Muhammedit s.a.v.s., dhe të mendohet hollësisht për to. Sepse ai është quajtur ‘*Xhevami-ul kelim*’ (thëniet kuptimplota, me pak fjalë), dhe i është dhënë kjo mundësi. Fjala e tij është thelbësore, edhe kur është e shkurtë, kuptimin e ka të gjerë. Çdo fjalë e tij është një oqean i diturisë. Nëse një dijetar i drejtë, vërtet posedon mundësinë e meditimit mbi fjalët e tij, ai nuk do të mund të ngrejë kokën nga fjala e tij për tërë jetën. Shpjegimi veç e veç për secilin ajet dhe hadith, do të zgjatej shumë.

Mendo hadithin ku Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**“Ruhu’l-Kudus (Xhebraili) më fryu këtë në zemër: *shpërblimi dhe ndëshkimi yt janë të lidhura për veprimet e tua.*”** Hadithi i përfshinë vendimet e kaluara dhe të ardhshme, e për ata që dëshirojnë të mendojnë, vetëm ky hadith do të ishte i mjaftueshëm. Sepse po ta kuptonin të vërtetën e hadithit dhe po ta vendosnin atë në zemër, ai kuptim do të përhapej në zemrat e tyre dhe do t’i pengonte që të mendojnë dynjanë.

Ja, këto janë rrugët e mendimit në dituritë praktike (*muamele*), për cilësitë e pëlqyera dhe të papëlqyera të robit. Fillimisht, udhëtari i ahiretit tërë kohën e kalon brenda këtyre mendimeve, dhe duke vlerësuar, e përmirëson zemrën me cilësi të bukura, me ahlak të bukur dhe me grada të ndershme, e pastron të brendshmen dhe të jashtmen nga gjendjet e këqija. E meqë tefekkuri është më i vlefshëm se ibadetet tjera, edhe qëllimi nuk duhet të jetë vetëm kaq. Ai që me këtë mjaftohet duhet ta kuptojë që kjo është më pak se qëllimi i sidikëve, e që është mendimi rreth Madhështisë (Xhelal) dhe Bukurisë

(Xhemal) të Allahut Teala. Kërkesa të tyre gjithashtu janë që zemrat të mbesin të preokupuara vetëmme dashurinë e Allahut, duke e harruar veten, gjendjen, gradën dhe cilësitë e veta. Ata janë si i dashuruari (*ashik*) që takon atë që e do dhe e harron veten e preokupohet vetëm me të dashurin. Kështu janë edhe sidikët karshi Allahut. Kjo arritje e dashurisë është kënaqësia më e lartë dhe e fundit e të dashuruarve.

Shpjegimet tona janë mënyrë e të menduarit rreth përmirësimit të brendshëm për të arritur në këto grada. Nëse njeriu tërë jetën është i zënë me përmirësimin e nefsit (vetes), kur do të kënaqet me afërsinë e Allahut? Në lidhje me këtë: me një rast, Ibrahim b. Ahmed el-Havasi po shëtiste në shkretëtirë, dhe u ndesh me Hysejn Mensurin, e ky e pyeti:

- *Çka je duke bërë këtu?* Havasi u përgjigj:

- *Po shëtis në shkretëtirë për të përmirësuar gjendjen e mendimit (tevekkul).* Hysejnii tha.

- *Haram të qoftë! Harxhon jetën në përmirësimin e brendësisë (batin), e ku është atëherë humbja (fena) në tevhid (njëshmëri)?*

Humbja në të Vërtetin, të Vetmin (*Vahid-i Hakiki*) është pika e fundit dhe dëshira përfundimtare e sidikëve. Largimi nga cilësitë e rrezikshme i përngjanë shpëtimit nga *iddet*-i në kurorë, kurse zbatimi i urdhrave të Allahut Teala i përngjanë pregaditjes së pajës së nuses. Edhe ngjyrosja dhe zbukurimi i nuses për të dalë në prani të burrit është një përgatitje. Por nëse tërë jeta kalohet vetëm në përgatitje, atëherë kjo do të bëhet pengesë për takim me të dashurin.



Kështu duhet kuptuar rruga e fesë, nëse je nga njerëzit e mexhllisit dhe muhabetit. Por nëse je si një skllav i keq, i cili vepron vetëm nga frika e dënimit dhe për shpërblim, atëherë merru vetëm me veprimet e jashtme të trupit, sepse mes teje dhe zemrës tënde ekziston një perde e trashë. Edhe nëse, duke zbatuar urdhrat si duhet, je nga banorët e xhenetit, nga njerëzit e sohbetit nuk mund të jesh.

Nëse ke kuptuar fuqinë e rrjedhjes së mendimit në dituri praktike mes robit dhe Rabbit të tij, kjo duhet të të bëhet adet për çdo ditë - mëngjes e mbrëmje. Dhe nuk duhet të jesh i pakujdesshëm bile as për një çast nga nefsi yt, që do të të largojë nga Allahu dhe nga gjendjet qetë afrojnë te Ai. Bile, çdo udhëtar i ahretit duhet të ketë një fletore për të shënuar cilësitë shkatërruese dhe shpëtuese që i ka, çdo zbatim dhe kundërshtim të urdhrave; çdo ditë të shikojë fletoren, e sipas saj të përmirësojë veten.

Nga të gjitha cilësitë shkatërruese, mjafton të vrojtohen vetëm dhjetë; nëse shpëton nga këto, ke shpëtuar edhe nga të tjerat. E ato janë: koprracia, kryelartësia, vetëlavdërimi, dyfytirësia, xhelozia, zemërimi i pamasë, pangopësia, epshi i tepruar, dashuria për pasuri dhe dëshira për famë. Edhe nga cilësitë e shpëtimit, të kujdeset vetëm për dhjetë, llogaritet e mjaftueshme. E ato janë: pendimi për gjynahet (*nedamet*), durimi në vështirësi, pëlqimi në caktimin e Allahut, falënderimi për mirësitë, maturia në frikë dhe shpresë, drejtimi kah ahireti, sinqeriteti në veprim, mirësjellja me njerëz, përulja dhe dashuria ndaj Allahut.

Ja, këto janë njëzet cilësi, dhjetë të papëlqyeshme dhe dhjetë të pëlqyeshme. Kur shpëton nga njëra prej këtyre cilësive të papëlqyeshme, duhet ta fshijë atë nga fletorja dhe të falënderojë Allahun, meqë shpëtimi nga kjo është me dhuratën e Tij. Pastaj duke marr në shqyrtim nëntë të tjerat, të mundohet të shpëtojë dhe të fshijë nga fletorja edhe ato, një nga një. Edhe me cilësitë shpëtuese njëjtë duhet vepruar. Shembull: kur pendohet fuqishëm (*pishman*) për gjynahet e bëra dhe premtion për të mos i përsëritur ato (*teube*), këtë ta fshijë nga fletorja, e të merr në shqyrtim nëntë të tjerat. Në këtë mënyrë, të përpiqet të arrijë sukses në të gjitha, një nga një. Kështu duhet të veprojë udhëtari i ahiretit.

E kur flitet për shumicën e atyre që llogariten të hairit (*salih*), ata duhet të shënojnë në fletore çdo gjynah të jashtëm (zahir), ushqimin e dyshimtë, telendisjen, bartjen e fjalëve të huaja, vetëlavdërimin, të folurit tej mase karshi miqve dhe armiqve, lajkat, braktisja e urdhërit për veprime të mira dhe largim nga të këqijat (*emr-i maruf* dhe *nej-i munkur*). Sepse shumica e atyre që e llogarisin veten si të hairit (*salih*) nuk kanë shpëtuar nga këto gjynahe. Ata që nuk e mbrojnë veten nga këto gjynahe, nuk janë duke punuar në përmirësimin dhe pastrimin e zemrës. Secili grup i njerëzve ka ndonjë gjynah kah i cili anon më shumë. Tani çdokush e njeh veten. Secili duhet të mundohet më shumë për t'u mbrojtur nga ai gjynah që e tërhjekë më shumë. Nuk ka nevojë të merret me gjynahun të cilin edhe ashtu nuk e pëlqen nga natyra.

Ta marim si shembull një dijetar të devotshëm. Për këtë dijetar, gjynahet si alkooli, bixhozi dhe të ngjashme nuk paraqesin rrezik; ai më shumë frikësohet nga dëshira për reputacion dhe famë përmes mësimdhënies dhe vaizit. Dijetari që ka këso dëshira dhe në to i kalon mendimet, bie në rrezik edhe më të madh. Nga kjo mund të shpëtojnë vetëm sidikët. Nëse fjala e dijetarit ndikon në zemra, ai tashmë nuk mund të shpëtojë nga vetëpëlqimi, stolisja e tepruar, kryelartësia dhe të folurit e të pavërtetave, e këto janë cilësi shkatërruese. Ai fillon të ndjej armiqësi dhe urrejtje ndaj atyre që nuk e pranojnë dhe vlerësojnë fjalën e tij. Ai zemërohet më shumë kur i refuzohet fjala e vet, se të refuzohet fjala e dikujt tjetër. Shejtani mundohet ta mashtrojë dhe i thotë: *'Zemërimi yt ndaj këtij personi nuk është çështje personale, është për të vërtetën që ai nuk e pranon.'* Nëse dijetari i tillë më shumë i zemërohet personit që e refuzon fjalën e tij se sa personit që e refuzon fjalën e vërtetë të dijetarit tjetër, atëherë është mashtruar dhe është bërë tall i shejtanit. Gjithashtu, ky mundohet që të folurit e tij të pranohet bukur, dhe i gëzohet lavdërimit. Nuk mundet të durojë refuzimin, prandaj nuk mund të vetëpërmbahet duke kërkuar më shumë lavdërim, me sjellje jo të sinqerta dhe fjalë të zbukuruara. Por Allahu Teala nuk e do demonstrimin e hipokritëve të tillë. Shejtani edhe këtu mundohet të mashtrojë, dhe thotë: *'Ti po kërkon fjalë të zbukuruara dhe gjeste të ndryshme me qëllim që të përhapësh fenë, për të mbrojtur drejtësinë dhe për të ndikuar zemrat. Këtu nuk ka asgjë të pahijshme.'*

Nëse dijetari gëzohet më shumë kur e lavdërojnë atë se sa kur lavdërohen dijetarët tjerë, edhe ky është mashtrim. Të tillët thonë që po përhapin fenë, e në fakt janë në ndjekje të famës. Personi që në brendësi ushqen mendime të tilla, ato fillojnë t'i shfaqen edhe në të jashtmen, dhe ky fillon të tregojë veten. Ai, duke besuar në vlerën e vet, gëzohet kur takohet me të tjerët që e nderojnë; dhe gëzohet kur njerëzit e preferojnë atë, ani pse ka dijetarë edhe më të vlefshëm. Bile fillojnë të sillen si gratë xheloze. Nëse nxënësi i njërit shkon te ndonjë dijetar tjetër duke menduar që ai është më i mirë, ky zemërohet.

Të gjitha këto janë shenja të cilësive të rrezikshme të fshehura në zemër. Përkundër kësaj, dijetari mendon që shpëtimi është në to, dhe zvarritet tutje në shkatërrim. Me këtë qëndrim dhe sjellje, sëmundjet e zemrës dalin në shesh. Po kuptohet që ngatërresa e dijetarit është e madhe; ose shpëton ose shkatërrohet. E shumica prej tyre edhe shkatërrohen. Nuk duhet mashtruar me shpëtimin e njerëzve të rëndomtë (avam), sepse avami në disa nga këto çështje ka të drejtë të kërkojë të falur.

Dijetari që e kupton që i ka këto cilësi të këqija në vete, e ka për detyrë (*vaxhib*) të tërhiqet në vetmi (*uzlet*). Bile edhe kur t'i kërkojnë fetvanë, le t'i drejtojë njerëzit te dijetarët tjerë, e vet le të preferojë vetminë. Mesxhidi Resul ka qenë mbushur me as'habë, të denjë për çfarëdo fetvaje. Megjithatë, ata i iknin kësaj, dhe drejtonin te tjetri. E ai që në fund detyrohej të japë fetva, do të thoshte: "*Sikur të*

*mos isha unë. Sikur t'ishte tjetri të japë këtë fetva."* Dijetari duhet të ruhet nga njerëzit shejtanë, të cilët thonë: *"Mos vepro kështu, nëse secili kështu vepron, dituria humbet."* Të tillëve thuaju: *"Islami nuk ka nevojë për mua; ai ekziston para meje, e do të ekzistojë edhe pas meje. Kurse unë kam nevojë për të përmirësuar zemrën. Është padituri të mendohet që mos-angazhimi im bëhet shkak për zhdukjen e diturisë."*

Edhe nëse për shkak të mësimin të diturisë të gjithë njerëzit burgosen, lidhen me zinxhirë dhe frikësohen me zjarr, dashuria për pushtet dhe epërsi i këput këta zinxhirë dhe i rrëzon muret; del nga aty, dhe prapë mirret me dituri. Pra dituria nuk do të zhduket përderisa shejtani ua zbukuron njerëzve pushtetin. E shejtani nuk hjekë dorë nga kjo detyrë, deri në kiamet.

Bile, dituria përhapet përmes njerëzve që nuk do të kenë përfitim në ahiret. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**"Allahu Teala këtë fe e përforcon me njerëz që nuk kanë hise në ahiret", dhe:**

**"Allahu Teala këtë fe e përforcon edhe me gjynahqarët."**

Kur dijetari mashtrohet me fjalënga njerëzit shejtanë, ai nuk mund të mësojë njerëzit tjerë përderisa nuk përmirëson së pari veten. Përndryshe i lind në zemër dashuria ndaj famës. E kjo do të ishte mbjellje e farës së dyftyrësisë. Ndërsa Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**"Si uji që rrit gjelbrimin, edhe dashuria ndaj pasurisë dhe famës rrit dyftyrësinë", dhe:**

**“Dy ujq të uritur që sulmojnë torishten e dhenëve nuk bëjnë më shumë dëm se sa dëmi në fenë myslimane që bën dashuria ndaj pasurisë dhe famës.”**

Dashuria ndaj famës largohet nga zemra vetëm me ndihmën e vetmisë (*uzlet*). Pra, dijetari duhet të hulumtojë këto sëmundje të fshehta në zemër dhe të mendojë për mënyrat e shpëtimit. Kjo është detyra kryesore e dijetarëve te devotshëm.

E njerëzit sikur ne duhet të mendojnë për mënyrat e përforcimit të besimit (*iman*) në ahiret. Ngase po të na shihnin gjenerata e parë (*selefi salihin*), do të thonin: ‘*Padyshim, këta nuk besojnë në ahiret.*’ Sepse veprimet tona nuk ngjasojnë me veprimet e atij që beson në xhenet dhe xhehenem. Është e vërtetë: ai që frikësohet ik nga çka frikësohet, e ai që dëshiron - kërkon çka dëshiron.

Ikja nga xhehenemi është e mundur, me braktisjen e harameve dhe gjërave të dyshimta. Ndërkaq nepikërisht atyre u jemi nënshtruar plotësisht, e jemi duke u zvarritur pas tyre. Kërkimi i xhenetit bëhet i mundur kur pas farzeve shtohen nafilet, e sot, edhe farzet po braktisen. Nga dituria ne sot përfitojmë vetëm dëshirën e zjarrtëpër dynjanë dhe që të tjerët të na përshtaten. E njerëzit e rëndomtë (*avam*) thonë: “*Po të ishte kjo botë (dynjaja) aq e keqe, dijetarët nuk do t’i shkonin pas.*” Dhe na marrin neve, dijetarëve, si shembull. Sikur të ishim edhe ne si njerëzit e rëndomtë e jo të bëhemi shembull i tillë, e kur të vdesim, edhe gjynahet tona

të vdisnin bashkë me ne! Nëse pak mendojmë, do të kuptonim se në çfarë ngatërrese të madhe ndodhemi. Nga Allahu Teala dëshirojmë që të na përmirësojë dhe para vdekjes të na mundësojë teube, neve dhe të tjerëve. Ai është Fisnik (*el-Kerim*) dhe Bamirës (*el-Lutuf*), që na drejton në rrugë të drejtë.

Këto janë rrugët e mendimit në dituri praktike (*muamele*), të dijetarëve dhe sidikëve. Kur realizohet kjo, përfundojnë detyrimet karshi vetvetes dhe pas kësaj ngrihet në mendim (tefekkur) mbi Lartësinë dhe Madhësinë e Allahut Teala, dhe arritja e kënaqësisë për të dëshmuar Allahun me syrin e zemrës. Padyshim që kjo arrihet pas shpëtimit nga të gjitha cilësitë shkatërruese, dhe duke u pajisur me cilësitë shpëtuese. Nëse para kësaj shfaqet diçka, ajo sigurisht është e përzier, turbullt dhe e mangët, dhe nëse arrin kënaqësi shpirtërore, ajo vjen e ikë si vetëtimë, pa vazhduar gjatë. Sikur personi që takohet me të dashurin, e nuk mund të ndjejë kënaqësinë e takimit, për shkak të shqetësimit për gjarpërin dhe akrepin që i ndodhen nën rroba. Për të arritur kënaqësinë e takimit, personit i duhet të pastrohet nga këto cilësi shkatërruese, nga këta gjarpërinj dhe akrepë.

Dhe kaq mjafton përsa i përket rrugëve të të menduarit (tefekkur) rreth cilësive të papëlqyeshme dhe të pëlqyera.

## PJESA E DYTË

Tefekkurirreth Madhësisë dhe Fuqisë Absolute të Allahut Teala, dhe kjo ka dy gradë:

a) Grada më e lartë është tefekkuri mbi kuptimet e Dhatit (Qenies) të Allahut Teala, cilësitë dhe emrate Tij. Por kjo na është ndaluar, sepse na është thënë: ***“Mendoni mbi krijesat që Ai i ka krijuar e jo Qenien e Tij (Dhatullah), sepse ju nuk keni fuqi ta mendoni qenien e Allahut Teala”***; mendja e njeriut këtu hutohet. Këtë mund ta durojnë vetëm të sinqertit (siddikun). Bile as ata nuk mund ta durojnë këtë pandërprerë. Vështrimi i njerëzve në Dhatin e Allahut Teala është si shikimi i lakuriqit të natës në diell- as që mund ta përballojë. Ditën edhe fshihet nga ai, për t’u kthyer natën e për të shikuar vetëm mbetjet e dritës së diellit, të rëna në tokë. E gjendja e të sinqertëve është sikur shikimi i njeriut në diell - mund të hedh një shikim, por nuk mund të shikojë pandërprerë. Nëse insiston, i rrezikohet të pamurit. Njëjtë është edhe me shikimin në Dhatin e Allahut; lindin hutia, frika dhe amullia mendore. Prandaj është më e dretë mos të dalldisemi në mendime për Dhatin e Allahut.

Shumica e mendjeve këtë nuk mund ta përballojnë, bile nuk mund të përballojnë as atë pak që dijetarët qartas e kanë thënë: që Allahu Teala është larg nga të qëndruarit në një vend të vetëm, dhe përtej asaj që të jetë në një drejtim të vetëm, ose përbrenda një dimensioni të vetëm. Allahu Teala nuk është as brenda gjithësisë, e as jashtë saj.



Mendjet e njerëzve janë aq të hutuara në këtë temë sa që disa bile edhe nuk pranojnë ekzistencën e Tij, e disa nuk mund të përballojnë as edhe më pak se kaq: kur u thuhet që Allahu Teala nuk ka gjymtyrë, nuk është materie dhe që Ai është Një dhe i Vetëm, fillojnë të mohojnë. Disa idiotë bile edhe thonë: *‘Një përshkrim i tillë i përshtatet përshkrimit të shalqirit indian, e jo përshkrimit të Allahut’*, sepse të tillët mendojnë që madhësia dhe madhështia janë këtu, në gjymtyrët tona. Arsyeja është që këta e njohin vetëm veten, prandaj e lartësojnë veten dhe nuk mund të kuptojnë madhësinë e diçkaje që nuk përngjanë në cilësitë e tyre. Pikërisht ashtu, kulmi i të menduarit të tyre është ta shohin veten të bukur, ulur në divan, me hyzmetqarët përreth, të cilët të nënshtruar kryejnë urdhrat e tij. Padyshim që i tilli edhe për Allahun Teala kështu mendon dhe madhësinë kështu e kupton. Edhe miza, po të kishte mendje, e t’i thuhet asaj: *‘Krijuesi yt nuk i ka dy krahë, as duar, as këmbë, e as nuk fluturon’*, edhe ajo do ta refuzonte këtë, e do të thoshte: *“Si mundet Krijuesi im të jetë më i mangët se unë?”* Mendjet e shumicës së njerëzve janë kështu. Njeriu vërtet është injorant, mizor dhe mohues. Prandaj Allahu Teala i shpalli njërit prej peygamberëve të Tij:

*“Mos u fol robëve të Mi për cilësitë e Mia, që të mos fillojnë të më mohojnë. Por t’u flasësh për Mua atë që mund ta kuptojnë.”*

E meqenëse mendimi (tefekkur) i Dhatit dhe cilësive të Allahut Teala është kaq i rrezikshëm, sheriatu urdhëron të mos bisedohet për Dhatin e Tij.

b) Prandaj edhe ne po kalojmë në gradën e dytë - të menduarit për veprat e Tij (*ef'al*), shtrirjen e fuqisë së Tij, mrekullinë në krijesa që Ai e krijoi, cilësitë e Tij të përsosur. Krejt kjo drejton në lartësinë e Tij, në përsosshmërinë e diturisë dhe urtësisë së Tij, në vullnetin dhe fuqinë e Tij. E atëherë njeriu le të shikojë cilësitë e Tij përmes veprave të cilësive të Tij, sepse ne nuk kemi fuqi të shikojmë drejtpërdrejtë cilësitë e Tij. Njëjtë siç nuk mundemi të shikojmë drejtpërdrejtë Diellin, por duke shikuar ndriçimin e Diellit në tokë kuptojmë madhësinë e Diellit. Drita në tokë është një nga gjurmët e dritës së Diellit, e nëse shohim gjurmët, ato tregojnë për shkaktarin e tyre, edhe nëse ne nuk e shohim atë shkaktar. Çdo grimcë në gjithësi është vepër e fuqisë së Allahut Teala dhe dritë nga drita e Dhatit të Tij. Nuk ka errësirë më të madhe se mosekzistenca (*adem*), e as dritë më të qartë se ekzistenca (*vuxhud*). Tërë gjithësia është një dritë (*nur*) nga nuri i Dhatit të Allahut Teala. Sepse shtylla e gjithë ekzistencës është me Dhatin e Tij, që ekziston vetvetiu. Kur lind Dielli, ne mund të vendosim një enë me ujë, dhe aty ta shikojmë Diellin. Kështu, uji bëhet mjet, që pak e zbehë dritën e Diellit, por me këtë na mundëson që ta shikojmë atë. Ashtu janë edhe veprat (*ef'al*) e Allahut mjet në të cilat i shohim cilësitë e Krijuesit. Për këtë Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

**“Mendoni krijesat që Ai i ka krijuar, e jo Qenien e Tij.”**

## KAPITULLI I KATËRT

### TË MENDUARIT RRETH KRIJESAVE TË ALLAHUT

Dije se, çdo gjë që ekziston, përveç Dhatit dhe cilësive të Allahut, është vepër dhe krijim i Tij. Në çdo grimcë, esencë, shenjë e cilësi, tregohet fuqia dhe dituria (hikmet) e Tij, dhe në gjithçka që Allahu nxjerrë në shesh ka gjendje të mahnitshme. Të numërohen të gjitha është e pamundur. Po te ishte deti ngjyrë për shkrim, as një pjesë e vogël e tyre nuk do të shkruhej e deti do të shteronte. Por, ne do të japim një përmbledhje të shkurtër, që të shërbejë si shembull për të tjerët, ku themi:

Ne nuk mund të mendojmë për ato krijesa për të cilat nuk kemi njohuri. Sa krijesa ekzistojnë, e që ne nuk i njohim. Në Kur’ani Kerim thuhet:

**“Ai krijon edhe gjëra që ju nuk i dini.”**

16-Nahl: 8

e në një ajet tjetër:

**“I pastër nga të metat është Ai që krijoi të gjitha llojet (çiftet) nga çka mbanë toka, nga vetë ata dhe nga çka ata nuk dinë.”** 36-Jasin: 36

Ekzistojnë edhe krijesa të tilla që, ne mund të njohim aspektin bazik dhe të përgjithshëm të tyre, por jo edhe hollësitë për to. Por, ne megjithatë posedojmë mundësi të mendojmë rreth hollësive të tyre. E ato ndahen në krijesa të cilat mund t’i njohim duke i parë me sy, dhe në ato që nuk mund t’i shohim. Krijesat që nuk mund t’i shohim janë melaqet, xhinët, shejtanët, Froni i Allahut (*Arsh*),

pedestali (*Kursi*) i Allahut, e krijesa të tjera. Të menduarit për to është shumë i vështirë, prandaj të mendojmë rreth krijimeve që kuptohen më lehtë, e të cilat i shohim me sy. Këto janë shtatë shtresa qiej, toka, dhe krijesat mes tyre. Qiejt perceptohen me yjet e tyre, dielli dhe hëna me lëvizjet e tyre. Toka perceptohet me kodrat e saj, mineralet, lumenjtë, detërat, kafshët dhe bimët. E ajo mes qiejve dhe tokës perceptohet me retë, shiun, borën, murmurimën, vetëtimën, bubullimën, vranësirën, fuqinë e erës. Këto janë krijime që mund të shihen në qiell, në tokë dhe mes tyre. Secila nga to ndahet në lloje, secili lloj ndahet në disa pjesë, e nga secila pjesë paraqiten shumë degë. Ndarjet në degëzime, pjesë, forma, cilësi, në kuptime të jashtme (zahir) dhe të brendshme (batin) nuk ka kufij. Krejt kjo hyn në fushën e të menduarit. Secila grimcë, e gjallë dhe jo e gjallë, në qiej, tokë dhe në atë mes tyre; të gjitha lëvizin me fuqinë e Allahut. Në secilën lëvizje ka nga një a më shumë urtësi (hikma). Secila prej tyre dëshmon për Njëshmërinë (*vahdaniija*) e Allahut Teala, dhe për fuqinë Absolutetë Tij.

Në Kur'an ka shumë ajete që inkurajojnë në mendim. Kështu, Allahu Teala thotë:

**“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendimtarët.”** 3-Ali Imran: 190, si edhe:

**“Dhe një prej shenjave të Tij është që qiejt dhe Toka qëndrojnë sipas urdhrit të Tij...”** 30-Rum: 25

Tani të shpjegojmë (cilësinë e) të menduarit (tefekkur) rreth disa ajeteve (shenjave). Njëra nga shenjat (ajetet) e Tij që tregon për Fuqinë dhe

Madhështinë e Tij, është krijimi i njeriut nga sperma (*nutfe*). E ti je më së afërti vetes tënde. Në ty ekzistojnë gjendje aq mahnitëse që tregojnë për Madhështinë e Allahut Teala. Gjithë jetën të mendosh vetëm rreth vetes, nuk do të kuptosh as një për qind, ndërsa ti je plotësisht në gaflet (pavëmendshmëri) nga kjo. Ti, që je i pavëmendshëm ndaj vetes tënde, që nuk e njeh as veten, si do të mund të njohësh diçka tjetër? Allahu Teala të ka urdhëruar që të mendosh mirë për vete:

**“Po edhe në vetet tuaja - a nuk e shihni vallë?”**

51-Dharijat: 21

Allahu të ka treguar që ti je krijuar nga një pikë e farës:

**“Mallkuar qoftë njeriu! Sa mosmirënjohës që është ai!**

**Prej çfarë gjëje e krijon Allahu atë?**

**Prej pikës së farës e krijon dhe i jep përmasa të rregullta.**

**Më pas ia lehtëson rrugën (e lindjes)**

**e pastaj e vdes dhe i cakton një varr,**

**dhe, kur të dojë, Ai e ringjall.”** 80-Abese: 17-22

**“Një prej shenjave të Tij është që Ai ju krijoj prej dheut, pastaj ja, tashmë ju jeni njerëz të shpërndarë në të gjitha anët.”** 30-Rum: 20

**“A s’ka qenë një pikë fare që derdhej, pastaj u bë droçkë gjaku e më pas Allahu e krijoi dhe i dha formë e përmasa të caktuara.”** 75-Kijame: 37-38

**“A nuk ju kemi krijuar nga një pikë lëngu të shpërfillur,  
të cilën e vumë në një vend të sigurt (mitër),  
deri në një kohë të caktuar?!”**

77-Murselat: 20-22

**“A nuk sheh njeriu se si Ne e krijuam atë prej pikës së farës, e megjithatë ai bëhet kundërshtar i hapët?!” 36-Jasin: 77**

**“Ne e krijuam njeriun nga një pikë farë e përzier.” 76-Insan: 2**

**“Me të vërtetë, Ne e kemi krijuar njeriun prej palcës së baltës, e pastaj, e bëmë atë pikë fare dhe e vumë në një vend të sigurt (mitër).**

**E mandej, pikën e farës e bëmë droçkë gjaku, e pastaj e bëmë copëz mishi pa formë; mandej, me atë mish bëmë eshtrat, pastaj i veshëm eshtrat me mish dhe pastaj e bëmë atë (njeriun) krijesë tjetër (duke i futur shpirtin). Qoftë lartësuar Allahu, Krijuesi më i përsosur!” 23-Muminun: 12-14**

Përsëritja e fjalës *“pikë e farës”* (*nutfa*) në Kur’ani Kerim nuk ka për qëllim që vetëm të dëgjohet ajo fjalë, por që të mendohet kuptimi i saj. E tani ta shqyrtojmë *‘pikën e farës’* - ajo është një pikë ujë i fëlliqur. Nëse për pak kohë qëndron nën ndikimin e ajrit, prishet dhe bie erë të keqe. Si e nxjerrë atë Allahu Teala nga kurrizi? Si i bashkoi mashkullin dhe femrën duke dhënë dashuri mes tyre, dhe si i lidh me zinxhirët e dashurisë dhe të epshit për marrëdhënie seksuale? Dhe si nga mashkulli e nxjerrë një *pikë farë*me lëvizje, dhe e nxjerrë lëngun e farës së femrës

nga thellësia, dhe si i bashkon në mitër? Më pas, si krijon fetusin nga pika e farës dhe e mbush me lëng, dhe si e ushqen deri sa ai të fitojë në masë? Se si pikën e shndërritshme të farës e kthen në mpiksje të kuqe? Më pas atë mpiksje e shndërron në një copëz mishi, dhe si i ndanë pjesët e pikës së farës në arterie, vena, inde dhe muskuj? Se si me përzierjen e muskujve, arterieve dhe venave krijon gjymtyrët, formëson kokën, i jep shqisat e të dëgjuarit, të pamurit, hundën, gojën dhe hapjet tjera? Më pas u jep formë duarve dhe këmbëve, dhe majat e tyre i ndanë në gishtërinjë, e gishtërinjëve u jep thonjtë. Më pas se si i përzien organet e brendshme: zemrën, lukthin, mëlçinë, shpretkën, mushkëritë, mitrën, fshikëzën, zorrët - secila prej tyre me formë të veçantë, dukje të veçantë, rol të veçantë - po të humbet vetëm një shtresë ose të zhduket vetëm një cilësi, syri do të humbas aftësinë e shikimit. Sikur të fillojmë të shpjegojmë vetëm disa nga këto gjymtyrë dhe organe, mrekullitë dhe shenjat e tyre, do të na kalonin jetët duke i shpjeguar.

Shih tash eshtrat. Ato janë pjesë të forta të trupit. Shih si i krijoi Allahu Teala ato nga pika e dobët dhe e hollë e farës, e më pas i bëri mbështetje dhe përforsim për gjithë trupin. Më pas u dha forma dhe madhësi të ndryshme. Kështu ekzistojnë eshtra të vegjël, të mëdhenj, të gjatë, të lakuar, të zbrazët, të fortë, të gjerë dhe të butë. Me qëllim që njeriu të lëvizë gjithë trupin e tij, ose vetëm ndonjë gjymtyrë, që të mund të kryejë diçka që i duhet, Allahu Teala nuk i dha atij vetëm një asht, por shumë sosh, të ndara mes vete me nyje, që njeriu të lëvizë më lehtë. Forma e secilit asht i përshtatet lëvizjes së dëshiruar.

Eshtra tjerë janë të bashkuar, dhe të lidhur mes vete me inde që rriten nga një asht e lidhen me tjetrin, mu si litari. Më pas, në njëren anë të ashtit Allahu krijoi zgjatje që del jashtë, e në ashtin tjetër krijoi gropë, ku ajo zgjatje nga ashti i parë përshtatet, me qëllim që eshtrat të lidhen mes vete. Kështu, kur njeriu dëshiron të lëvizë një pjesë të trupit të vet, nuk pengohet. Po të mos kishte ndarje mes eshtrave, njeriu nuk do të mund të lëvizte.

Gjithashtu, shiko eshtrat e kokës, se si Allahu Teala aty i bashkoi pesëdhjetë e pesë eshtra, të formave dhe dukjeve të ndryshme. I bashkoi njëri me tjetrin, duke i dhënë kokës formën që ti e sheh. Në mesin e tyre janë gjashtë eshtra të veçantë të kafkës. Pastaj katërbëdhjetë eshtra për nofullën e epërme, dhe dy për të poshtmen. Eshtrat tjerë janë dhëmbët; disa të gjatë - për përtpje, të tjerët të mbrehtë - për prerje. Shih qafën, që është si mbajtës i kokës, e përbërë nga shtatë rruazat e qafës. Në to ka lakesa, thellime, ngushtime - që rruazat të lidhen njëra me tjetrën, e të flasim për urtësitë edhe për formën e tyre, do të zgjatej shumë. Më pas Allahu Teala e vendosi qafën në shpinë. Nga pjesa e poshtme e qafës ka vazhduar me unazat e shtyllës kurrizore, e më pas me tri pjesë të ndryshme. Më pas, me rruazat e bishtit, që gjithashtu i ka tri pjesë. Më pas e lidhi kurrizin me eshtrat e gjoksit, të krahërorit, duarve, prapanicës, kofshëve, këmbëve dhe gishtave të këmbës. Nuk do të vazhdojmë e t'i numërojmë të gjithë eshtrat. Totali i eshtrave në trupin e njeriut është dyqind e katërdhjetë e tetë, duke mos llogaritur eshtrat e vegjël, të ndarë mes vete me



zbrazëtira. Shih si Allahu Teala i krijoi të gjitha këto nga një pikë e parëndësishme e farës!

Qëllimi i përmendjes së eshtrave nuk është që të dihet numri i saktë i tyre. Ajo dituri u takon mjekëve, atyre që e njohin anatomicinë. Qëllimi është të mendohet në renditjen e tyre, dhe në Krijuesin e tyre - si i renditi, bëri që të jenë të ndryshëm në formë dhe madhësi, dhe si ka vendosur që të jenë pikërisht në këtë numër, sepse po të rritej numri i tyre vetëm për një, njeriut do t'i duhej ta largojë atë asht të tepërt. E sikur t'i mungonte vetëm një, do të ishte kjo e metë që duhet plotësuar. Mjeku, përmes kontrollës, e cakton se si duhet kompenzuar ajo e metë. Mjeku i merr këto në shqyrtim me qëllim të shërimit. Kurse personi mendjemprehtë aty sheh dëshmitë e madhështisë së Krijuesit, i Cili u ka dhënë formën. Mes këtyre dy shikimeve dallimi është shumë i madh.

Tash shih se si Allahu Teala krijoi organet për lëvizjen e eshtrave - muskujt. Në trupin e njeriut krijoi pesëqind e njëzet e nëntë muskuj. Muskuli përbëhet nga mishi, nervat, indet dhe lëkura. Janë me madhësi dhe forma të ndryshme, përshtatshëm vendit ku gjenden dhe qëllimit për çka përdoren. Njëzet e katër muskuj përdoren për lëvizjen e bebëzave dhe kapakëve të syrit. Po të mungojë vetëm një muskul nga ta, gjendja e syrit prishet. Njëjtë, për secilën gjymtyrë ekziston numër i caktuar i muskujve dhe fuqi saktësisht e caktuar për ta. Kurse nervat, arteriet, venat dhe enët e gjakut, numri i tyre, vendet e fillimit dhe degëzimet e tyre janë edhe më të habitshme. Komentimi i tyre do të tejzgjatej.

Të menduarit (tefekkur) mund të jetë i lidhur me këto pjesë, më pas me gjymtyrët, e pastaj edhe me gjithë trupin. Krejt kjo është vërtetim i mrekullive të trupit. E kuptimi i këtyre mrekullive zakonisht nuk arrihet me shqisa fizike.

Shih tash të jashtmen e njeriut, dhe të brendshmen e tij, trupin dhe cilësitë e tij. Aty do të shohësh aq shumë habi dhe gjëra unike, e të gjitha ato Allahu Teala i krijoi nga një pikë e lëngut të fëlliqur. Çka mendon ti, Ai që i krijoi të gjitha këto nga një pikë e lëngut, a thua çfarë ka krijuar në qiell dhe në yje? Çfarë urtësie e Tij mund të lexohet nga pozitat e tyre, format, dimenzionet, numri, dendësia dhe largësia, dallimet në dukje dhe ndarja e tyre në lindore dhe perëndimore? Assesi mos mendo që ekziston edhe një grimcë, e të mos ketë urtësi. Aq më shumë, vetëm në atë grimcë ka krijime më të përsosura dhe me më shumë mrekulli, se sa në trupin e njeriut. Për këtë Allahu Teala thotë:

**“Cili është më i vështirë: krijimi i juaj apo i qiellit, të cilin Ai e ndërtoi, ia ngriti lart kupën dhe e përsosi.**

**Netët i bëri të errëta, kurse ditët të ndritshme.”** 79-Naziat: 27-29

Tash kthehu në të menduarit për pikën e farës. Mendo gjendjen e saj në fillim, epastaj edhe formën e saj finale. Mendo pas kësaj, sikur të bashkoheshin xhinët dhe njerëzit me qëllim që nga pika e farëstë krijojnë vetëm dëgjimin ose shikimin, arsyen ose forcën, diturinë, shpirtin, a që nga ajo të krijojnë eshtrat ose venat, nervat a lëkurën, a do të ishin në gjendje ta bëjnë këtë?

Por, t'i lëmë anash të gjitha këto sepse Allahu Teala e krijoi atë pikë fare, prandaj ku munden njerëzit ta kuptojnë se çka është hakikati i saj dhe si është krijuar?

Ti habitesh kur sheh njeriun në letër, të pikturuar me aq mjeshtëri nga artisti, që duket si i vërtetë. Ti mahnitesh me veprën e artistit, aftësitë e tij, përpikshmërinë e duarve të tij, mendjen e tij të mprehtë, dhe kështu në zemrën tënde rritet vendi për të, ani pse ti e di që piktura e artistit është bërë me ngjyra, brushë, duar, letër, forcë, dituri dhe vullnet. E këto janë krijime të dikujt tjetër. Kulmi i veprës së tij është vendosja e ngjyrës në letër. E përkundër kësaj, ti e admiron dhe respekton shumë artistin.

Nga ana tjetër, ti sheh një pikë të një lëngu të parëndësishëm, dhe beson se ajo nuk ka ekzistuar më parë. Atë e ka rijuar Krijuesi i saj, në mes të kurrizit dhe brinjëve, e më pas e nxorri jashtë. I dha formën më të bukur, pjesët e saj të ngjashme i ndau në pjesë të ndryshme, dhe gjithkrah vuri eshtra. U dha formë të bukur gjymtyrëve të asaj pike, dhe zbukuroi të brendshmen dhe të jashtmen e saj. I vendosi venat dhe nervat ashtu që të jenë mënyrë për t'u ushqyer për atë pikë, që prapë, i mundëson asaj ekzistencën. I dha të shohë, të dëgjojë, të dijë, të flasë. I krijoi shpinën si shtyllë e trupit të saj, dhe barkun si vend ku mblidhet ushqimi. E kokën ia bëri vend ku mblidhen të gjitha shqisat. Ia hapi dy sy, i organizoi shtresat e tyre, u dha pamjen, ngjyrën dhe formën e bukur. Më pas i mbuloi me kapakë, që t'i fshehë dhe ruaj, dhe që nga ta të largojë pluhurin. Më pas, thjerrëzave të tyre u dha mundësinë të shohin

pamjen e qiellit, me të gjitha horizontet qiellore dhe hapësirat e largëta. Në kokë i mbolli dy veshë, dhe në ta vendosi lëng të idhët që të ruajë dëgjimin dhe të pengojë hyrjen e ajrit. I mbështolli me lapra që ato të mbledhin tingujt e t'i dërgojnë në kanalet e dëgjimit. Në veshë vendosi lakesa, që të shpejtohet lëvizja e tingujve. Zgjati kështu rrugëtimin brenda veshit, në mënyrë që njeriu, edhe kur të jetë fjetur, të ndjejë që diçka po i vjen në vesh. Në mes të fytyrës së njeriut e ngriti hundën, dhe i dha formë të bukur. I hapi në të dy vrima dhe aty vendosi shqisat e nuhatjes, që njeriu të mund të nuhasë aromën e asaj që ha, dhe që me këto vrima të marrë frymë, të marrë ushqim për zemrën e tij dhe të ajrosë organet e brendshme. Në kokë i hapi gojën, dhe në të vendosi gjuhën që të mund të tregojë atë që ka në zemër. Gojën e hijeshoi me dhëmbë, si mjete për bluarje, thyerje dhe prerje. U forcoi rrënjën, u mbrehi majat, ua bëri sipërfaqen e bardhë dhe i vendosi ashtu që majat e të gjithëve janë në nivel të njëjtë, dhe janë të renditur si margaritarë të bardhë. Krijoi dy buzë, u dha ngjyrën dhe formën më të bukur që ato të mbyllin gojën dhe ta mbrojnë atë, dhe që përmes tyre të krijohen tingujt. Krijoi fytyrën, dhe bëri që nga aty të dalë zëri. Krijoi gjuhën dhe i dha asaj mundësinë e lëvizjes dhe ndalesës, që të ndërpresë tingullin, me çka shkronjat dallojnë mes vete. Dhe krejt kjo me qëllim që të zgjerohet artikulimi, përshtatshëm numrit të madh të tingujve të ndryshëm. Edhe fytyrën i bëri të ndryshëm: më të ngushtë, më të gjerë, të gërryer, të lëmuar, të fortë, të butë, të gjatë e të shkurtë, prandaj edhe zërat e tyre janë të ndryshëm. Kështu, nuk ka dy zëra të njëjtë. Mes dy zërave ka dallim, prandaj dëgjuesi

mund të dallojë edhe në errësirë një person nga tjetri, vetëm në bazë të zërit. E zbukuroi kokën me flokë dhe ballë, e fytyrën me mjekër dhe me dy vetulla, vetullat me qime të holla e formë të lakuar, e sytë i zbukuroi me qerpikë. I krijoi organet e brendshme dhe secilit i caktoi një detyrë. Kështu lukthin e caktoi të tretë ushqimin, mëlçinë që ushqimin ta kthejë në gjak, kurse shpretkën, tëmthin dhe veshkët, prapë, në shërbim të mëlçisë. Shpretka shërben ashtu që nga ushqimi ndanë të zezën, tëmthi ndanë të verdhën, kurse veshka ndanë lëngun. Fshikëza u shërben veshkëve ashtu që merr nga to lëngun, e më pas e tretë dhe nxjerrë jashtë. Venat shërbejnë për furnizim me gjak të pjesëve tjera të trupit.

Allahu Teala i krijoi njeriut dy duar. I zgjati ato, që njeriu të mund të kapë, ia zgjeroi shuplakën, i dha pesë gishtërinj, e secilin gisht e ndau në trinyje. Katër gishta i krijoi, jo të njëjtë por njëri pranë tjetrit. Gishtin e madh e krijoi anash, që me të përthëkojë katër të tjerët. Sikur të mblidheshin të gjitha gjeneratat e para dhe të fundit, me qëllim që të gjejnë mënyrë tjetër funksionale për të renditur gishtërinjtë, ndryshe nga kjo që është - nuk do t'ia arrinin qëllimit.

Pra, me këtë organizim të dorës dhe gishtave njeriu mund të mbajë në dorë, dhe të shtrijë dorën. Po ta shtrijë, bëhet si tabak e në të mund të vendosësh gjëra. Po ta bëjë grusht, me të mund të godasë, e po ta mbyll vetëm pjesërisht, mund të kap gjëra. Nëse e hapë dorën e gishtat i afron, i bëhet si krehër. Në maja të gishtërinjëve Allahu Teala i krijoi

njeriut thonjtë, si zbukurim dhe mbrojtje, dhe që me ta të mund të mbledhë gjëra që me gishtërinj nuk mundet, por edhe të bluaj, nëse i duhet. Thoni duket si organ i parëndësishëm. Por, po të mos e kishte njeriu, e t'i lajmërohej një e kruar, do të bëhej krijesa më e pafuqishme. Askush tjetër nuk do ta kruante. Po ta luste tjetrin që ta kruaj, ky do të kërkonte vendin e kruarjes gjatë, deri sa të lodhej. E kështu, ky vet, thjesht zgjatë dorën te pjesa që i kruhet, deri sa ta arrijë, qoftë edhe në gjumë, bile edhe i pavetëdijshëm që ka nevojë për t'u kruar.

Të gjitha këto Allahu Teala i krijoi nga një pikë lëngu të vendosur në mitër, në tri mbulesa. Po të ishte e mundur të shihej ajo pikë nën këto mbulesa, do të shihnim tërheqjen e vijave dhe formësimin, pak nga pak, por nuk do të shihej Ai që jep formën, e as pajisjet e Tij.

E, a mos ke parë ti ndonjë artist, ose cilin do krijues të çfarëdo vepre, të mos i prekë mjetet e tij, e megjithatë të krijojë?

Prandaj, hamd vetëm Allahut, sa i Lartësuar që është Ai, e sa të qarta i ka shenjat! Shih edhe rahmetin e Tij, krahas gjithë përsosshmërisë së fuqisë së Tij. Po të mos e ngushtonte mitrën, fëmija nuk do të mund të rritej. Shih si e nisë në rrugëtim, e fëmija fillon të lëvizë me kokë e me trup, dhe del nga ajo hapësirë e ngushtë. E kërkon daljen, thuajse sheh se për çka ka nevojë. E pastaj, kur të dalë e t'i nevojitet ushqim, si e udhëzon Allahu Teala e ai di të thithë. Trupin e ka të dobët e nuk mund të pranojë ushqim të fortë, prandaj Allahu Teala e ndihmon, duke

krijuar për të qumësht ushqyes, që bëhet në bark e nga gjaku, por është i pastër dhe i shijshëm.

Se si i krijoi dy gjinj, e vendosi qumshtin në to dhe bëri që ai lehtas të rrjedh nëpërmes thimthave, që i sapolinduri të mund ta pranojë me gojën e tij. Në thimtha vendosi vrima aq të vogla, sa qumështi mund të rrjedhë vetëm pasi fëmija ta thithë, gradualisht. Fëmija i vogël mund të ushqehet vetëm nga pak, prandaj si e ka udhëzuar Allahu Teala që, nëse është shumë i uritur, duhet të thithë, që nga ato vrima të vogla të rrjedhë qumësht.

Shih më pas butësinë dhe dhembshurinë e Tij, se si bëri që njeriut dhëmbët t'i rriten vetëm pas dy viteve, sepse në dy vitet e para njeriu ushqehet vetëm me qumësht, prandaj edhe nuk i duhen dhëmbët. E kur të rritet, nuk i mjafton vetëm qumështi i butë, por ka nevojë edhe për ushqim më të fortë. E ushqimin e tillë duhet përtypur e bluar, prandaj edhe i janë krijuar dhëmbët pikërisht kur i duhen, as më herët e as më vonë. Vërtet, Lavdëruar qoftë Ai, se si i nxjerrë ata eshtra të fortë nga mishi i butë.

E zemrat e prindërve i mbushi me dashuri për të sapolindurin, prandaj ata i kushtojnë gjithë kujdesin atij, në kohën kur ai është i pafuqishëm, e ndihmojnë. E sikur Allahu Teala të mos kishte dhënë që zemrat e tyre t'i pushtojë dhembshuria, fëmija do të ishte krijesa më e pafuqishme.

Shih se si më pas Allahu Teala i jep të sapolindurit forcë trupore, fuqinë e vlerësimit, arsyen, udhëzimin, të gjitha - deri sa ai rritet e pjeket - fillimisht duke hyrë në pubertet, më pas në rini, pastaj në burri, dhe në fund, në pleqëri, qoftë ai

jobesimtar apo falendërues Allahut, i nënshtruar apo i padëgjueshëm, sipas fjalëve të Allahut Teala:

**“Vallë, a nuk ka kaluar një periudhë kohore, kur njeriu nuk ka qenë qenie e denjë për t’u përmendur?!**

**Në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun nga një pikë farë e përzier, për ta sprovuar dhe e bëmë që të dëgjojë dhe të shohë.**

**Natyrisht që Ne i treguam atij rrugën e drejtë, që ai të jetë ose mirënjohës, ose mosmirënjohës.”**

76-Insan: 1-3

Shih mirësinë e Allahut Teala, e pastaj shiko fuqinë dhe urtësinë që mahnisin mendjet.

E habia mbi habitë është njeriu që, kur sheh një shkrim ose filigran të bukur, kjo i lë atij përshtypje aq të thellë sa që ai gjithë *mendimet* i drejton kah artisti, e simpatia që ndjen për të sa vjen e shtohet, e thotë: *“Sa i aftë që është, sa bukur e ka punuar!”* E më pas i sheh gjithë këto mrekulli në vete e në të tjerët, por bie në gaflet ndaj Krijuesit të vet, ndaj Atij që i dha formën, nuk e mbush admirimi ndaj Lartësisë së Tij, Madhësisë dhe Urtësisë së Tij.

Krejt kjo që treguam është vetëm një grimcë e mrekullive në trupin tënd, dhe është e pamundur të hulumtohen të gjitha. Kjo që e shpjeguam është më së afërti rrjedhjes së *mendimeve* tua, dhe shenjë e qartë e Lartësisë së Krijuesit tënd.

Kurse ti je i pakujdesshëm ndaj kësaj, i fokusuar vetëm në barkun dhe organin tënd. Për vete di vetëm kur je i uritur, e atëherë ha, pi dhe fle, nxehesh dhe kryen marrëdhënie, hidhërohesh e sulmon.



Të gjitha kafshët e bëjnë këtë. Por, e veçanta e njeriut, nga e cila kafshët janë të privuara, është njohja e Allahut Teala përmes vrojtimit të realitetit të qiejve dhe Tokës, dhe mendimit rreth mrekullive të jashtme dhe të brendshme.

Me këtë, njeriu hyn në grupin e afërt me melaqet, dhe ngjallet në shoqëri të pejgamberëve e sidikëve, në afërsi të Rabbit të të gjitha botëve. Ajo pozitë nuk është për kafshët, por nuk është as për njeriun që kënaqet me dynjallëkun përmes epsheve shtazarake. Ky është më i keq, sepse kafsha nuk e ka mundësinë e njohjes, derisa njeriut Allahu Teala ia dha këtë mundësi. E njeriu e neglizhon, dhe është jofalënderues ndaj mirësive. Ti je si kafsha, edhe më i keq bile!

Pasi të kesh njohur mënyrën e meditimit për vete, medito për Tokën - vendndodhjen tënde, e më pas për lumenjtë, detërat, malet dhe mineralet, e në fund ngritu nga Toka drejt mbretërive qiellore.

Si shenja të Tokës llogariten krijimi i saj si shtrojë dhe vend-pushim, shtrirja nëpër të e rrugëve të gjëra. Është bërë e përshtatshme që të ecet nëpër peizazhet e saj, stabile. Malet i janë dhënë si shtylla, të mos luhatet. Anët i ka të gjëra, e njerëzit nuk mund t'i vizitojnë të gjitha, edhe sikur të jetonin gjatë e të udhëtonin shumë. Allahu Teala thotë:

**“Ne, me forcën tonë e ngritëm qiellin dhe Ne e zgjerojmë atë.**

**Edhe tokën Ne e kemi shtruar, sa shtrues të mirë jemi.”** 51- Dharijat:47-48,

e me një ajet tjetër:

**“Ai jua ka bërë Tokën të përdorshme, andaj ecni nëpër viset e saj...”** 67- Mulk: 15,

edhe me një ajet:

**“I Cili e ka bërë për ju tokën shtresë dhe qiellin ndërtesë;”** 2-Bekare: 22

Allahu Teala shpesh e përmend tokën në Kur’ani Kerim, në mënyrë që ne të mendojmë rreth mrekullive në sipërfaqen e saj:

**“A nuk e kemi bërë Tokën vendqëndrim për të gjallët dhe për të vdekurit...”**

77-Murselat: 25-26

Shihe tokën, dimrit është si e vdekur, e tharë. Me shiun e pranverës ajo ngjallet, jep bimë të mrekullueshme dhe gjelbrohet, e prej saj dalin lloje të ndryshme të krijesave të gjalla.

Pastaj shiko se si Allahu Teala vendosi që në Tokë të ketë male të palëvizshme, të larta, masive, të forta. Se si nën to Allahu Teala dha ujë, që nga Toka të shpërthejnë burime, e lumenjtë të rrjedhin në sipërfaqen e saj. Nga guri i thatë dhe dheu i pluhërosur Ai dha të del ujë i mirë, i ëmbël, i pastër, i kthjellët. E me këtë ujë rriten lloje të ndryshme të drunjëve dhe bimëve - drithërat, rrushi, kallami, ullinjtë, palmat, shega, pemë të ndryshme sa që nuk numërohen, të formave, ngjyrave, shijeve, cilësive e aromave të ndryshme. Disa pemë janë më të shijshme se tjerat, e të gjitha ushqehen me ujin e njëjtë, dalin nga e njëjta tokë.

Nëse kundërshton e thua: *“Janë të ndryshme sepse i kanë të ndryshme farën dhe rrënjët”*, atëherë si gjendet në një farë të vetme e gjithë pema e hurmës e ngarkuar me aq shumë fruta? Dhe si është e mundur që në një frut janë shtatë boqe, e në secilin boq nga qindra fara?! Këtë mendo.

Vrojto shkretëtirën dhe shih të jashtmen e të brendshmen e saj. Do të shohësh që e tëra është me grimca pluhuri, të ngjashme mes vete. Por, kur bjen shiu mbi to, si dalin nga aty lloje të mrekullueshme të bimëve, me ngjyra të ndryshme, të përafërta ose të dallueshme mes vete. Secila ka shije, aromë, ngjyrë dhe formë tjetër.

Pra shih sa të shumta janë, gjithë ajo llojllojshmëri, forma të shumta të natyrave të ndryshme, dhe mendo dobitë e shumëllojshme nga to, dhe si disa janë edhe shërim.

Një lloj bime është ushqim, tjetra është ilaç, e një lloj tjetër është helm vdekjeprurës; një lloj ftohë, një tjetër lloj ngrohë. Njëra, kur depërton në lukth, e mposhtë verdhëzën nga arteriet më të thella, e tjetra e shkakton verdhëzën. Njëra mposhtë mukozën, tjetra e shkakton. Njëra pastron gjakun, tjetra e shton atë. Njëra disponon, tjetra vë në gjumë, njëra forcon, tjetra të ligëson. Secila bimë që del nga toka ka aq shumë dobi sa nuk mund të numrohen. Nga toka nuk ka dalë asnjë gjeth, asnjë barishte, e të mos bart në vete dobi që njeriu nuk është në gjendje t’i zbulojë. E sa ka bimë që i nevojiten fshatarit, i cili kujdeset për secilën në mënyrë të caktuar; hurmëne sharton, lozën e verës e krasit,e nga drithërat heq barin e keq.

Disa bimë mbijnë me mbjelljen e farës së tyre në dhé, disa me mbjellje të degës, e disa me shartim në dru. Sikur të numëronim të gjitha llojet e bimëve, nënlllojet, dobitë, gjendjet dhe bukuritë e secilës prej tyre, do të harxhonim shumë ditë vetëm me këtë. Ty të mjafton që nga cili do lloj të marrësh një shembull, që do të të shtyejë në mendim (*tefekkur*). Kaq për mrekullitë e bimëve.

Gjithashu, disa nga shenjat e Allahut janë edhe gurët e çmuar, të palosur nën male, dhe minierat nën tokë. Njëra pranë tjetrës, e prapë, të ndryshme mes vete.

Vrojto malet, se si nga to nxirren gurë të çmuar, ar, argjend, rubin, xhevahir, granit e tjerë. Disa nga to punohen me çekiçin e farkëtarit, si ari, argjendi, bakri, plumbi e hekuri, të tjerat jo, si rubini ose graniti. Shih si i udhëzoi Allahu Teala njerëzit që t'i gërmojnë, më pas t'i pastrojnë, e nga to të krijojnë kurthe, vegla, para e stoli.

Pastaj shiko mineralet në tokë: petrol, sulfurin, katranin e të tjera, e më e lira nga to është kripa, që njeriut i duhet vetëm kur dëshiron të përmirësojë shijen e ushqimit. Magjithëkëtë, nëse ka mungesë, njerëzit edhe mund të vrasin për të.

Shih Rahmetin (mëshirën) e Allahut Teala, se si disa pjesë të tokës i krijon me shtresa që përmbajnë kripë, bashkë me pasuri tjera. Aty është prezent uji i pastër nga shiu, që shndërrohet në kripë, e krejt kjo vetëm që ti të shijosh ushqimin tënd, të kesh jetë më të mirë.

Nuk ka asnjë krijim, të gjallë a jo gjallë, e që aty të mos ketë një ose më shumë urtësi (*hikmet*). Allahu Teala asgjë nuk ka krijuar kot. Të gjitha i ka

krijuar në formë të merituar dhe me qëllim të caktuar. Allahu Teala thotë:

**“Ne nuk i kemi krijuar qiejt, Tokën dhe çfarë gjendet midis tyre, për t’u zbavitur!**

**Ne i kemi krijuar ato me qëllim të plotë, por shumica e tyre nuk e dinë.”** 44-Duhan: 38-39

E një nga veprat e Tij janë edhe llojet e ndryshme të kafshëve, ndarja e tyre në ato që fluturojnë dhe në ato që ecin, pastaj ndarja në ato që ecin me dy këmbë, me katër, dhjetë, a njëqind, siç mund të shohim te disa lloje. Shiko pamjen dhe formën e tyre, natyrën dhe dobitë. Shiko zogjtë në ajër, kafshët e egra në tokë, dhe ato shtëpiaket. Do të shohësh mrekulli, e nuk do të mbetet dilemë për lartësinë e Krijuesit të tyre, fuqinë e Tij - se si i ka krijuar, dhe urtësinë e Tij - si u ka dhënë formë. Sikur të mendonim vetëm mrekullitë që gjenden te miza, milingona, bletaose merimanga - te kafshët më të vogla që ndërtojnë fole për vete; të mendojmë të gjitha mënyrat e tyre të furnizimit, shumimin, lëvizjen gjatë ndërtimit të folesë, deponimin e ushqimit, jetën së bashku - nuk do të mund t’i kuptojmë të gjitha, dhe do të habitemi shumë. Mund ta shohësh merimangën se si i bën vetes shtëpi buzë lumit. Fillimisht i kërkon dy vende, afër mes vete por me zbrazëtirë në mes, të madhësisë së një bërnyli a diçka, që të mund t’i lidhë të dyja mes vete me fijet e rrjetit. Pastaj fillon të gërhasë, lëshon pështymë, që është litari i saj, e lëshon anash, që të ngjitet. Pastaj kalon në anën tjetër që të përforcojë fijet. Këtë e përsërit dy a tri herë, dhe kështu bën lidhje në mes të dy anëve, i lidh ato me ndërtim. Kur e përforcon

kurthin dhe fijet i lidh si bazament të teksturës, merret me pëlhurën. Ato lidhje i vendos në fije, njëra mbi tjetrën. Nyjet i shtrëngon në vendet ku lidhen fijet me pëlhurën. Dhe në krejt këtë punë është e kujdesshme, tamam si një ndërtues.

Në atë rrjet i ngjiten tartabiqa dhe miza. E merimanga qetësohet në njërën anë, duke pritur gjahun të bjerë në rrjet. Kur diçka kapet, merimanga vrapon ta marrë gjahun dhe ta hajë. Por nëse nuk arrin të kapë asgjë, shkon në ndonjë qoshe të ndonjë muri. Anët e qoshes i lidh me ndihmën e fijeve, e në ato fije vjerret me një fije tjetër dhe qëndron pezull në ajër duke pritur ndonjë mizë të fluturojë. E kur ajo vjen, i gjuhet dhe e kapë. E lidh fijen e vet në këmbën e mizës, e shtrëngon fort, dhe në fund e ha.

Nuk ka asnjë kafshë, të vogël a të madhe, e që në vete të mos ketë aq shumë mrekulli, të panumërta. A mendon ti se merimanga i zbuloi vetë të gjitha këto? Ose që të tjerët e mësuat? A nuk e kupton që këto krijesa janë meskine, të dobëta dhe të pafuqishme? Në anën tjetër, elefanti është kafshë e madhe, e prapë i pafuqishëm për disa gjëra që merimanga mund t'i bëjë. Si mundet një kafshë aq e madhe të jetë e pafuqishme? A nuk e shohin të gjithë pamjen e elefantit, madhësinë, lëvizjet dhe mrekullitë e ekzistencës së tij, që dëshmojnë për Krijuesin e tij, të Gjithëdijshtin?

Personi mendjemprehtë, vetëm në atë kafshë të vogël, pa i marrë parasysh fare kafshët tjera, njuh Lartësinë e Krijuesit, Përcaktimin e Tij, Fuqinë dhe Urtësinë e Tij Absolute, që mahnisin të gjitha mendjet. Ky kapitull nuk përfundon. Nuk ka fund në numërimin e të gjitha kafshëve dhe pamjeve të tyre,

cilësive dhe natyrave të tyre. Por, habia e zemrave mungon, sepse ne i shohim këto kafshë çdo ditë. Dhe vërtet kështu është, sepse po të shihej ndonjë kafshë e rrallë dhe e pazakontë, qoftë edhe krimb, prapë lajmërohet habia te njeriu, e thotë: “*Subhanallah, mrekuilli!*”.

E njeriu vet është gjallesa më e mrekuillueshme, por prapë nuk habitet me veten e tij. Sikur njerëzit t’i mendonin bile kafshët që vazhdimisht i kanë pranë; mishin dhe qumështin e tyre që Allahu Tealaua dha njerëzve për ushqim; lëkurën, leshin, qimene tyre, të cilat Allahu Teala i dha të shërbejnë si rroba, strehim në rrugëtime, enë për ushqim dhembrojtje për këmbë, e më pas disa kafshë i bëri për kalërim, të tjerat për bartje të mallit; sikur njerëzit t’i mendonin të gjitha këto, format dhe pamjet e këtyre kafshëve, dobitë dhe mirësitë që ato i japin, sigurisht se do të mahniteshin nga urtësia e Krijuesit të tyre. Të gjitha ato i krijoi Ai që e di saktësisht dobinë e secilës prej tyre, para se T’i ketë krijuar. Ai krijon atë që dëshiron. Ai është Alim, Habir, Hakim, Kadir. Këtë krijim e dëshmuan arifët, të cilët besuan me zemër në njëshmërinë e Tij (*tevhid*). E njerëzit e rëndomtë, munden vetëm t’i nënshtrohen mbi-fuqisë dhe madhësisë së Tij, dhe të pranojnë Rubbubijetin, e kështu edhe të vërtetojnë pafuqinë e vet për njohje të plotë të Madhësisë dhe Lartësisë së Allahut Teala. Askush nuk mund ta lavdërojë Atë siç duhet. Ai është i tillë siç e ka lavdëruar Vetën. Kulmi i njohjes tonë është njohja e pafuqisë tonë për njohje të plotë të Tij. Lusim Allahun Teala të na nderojë me udhëzimin e Tij, bereqetin e Tij dhe rahmetin e Tij.

Shenja nga Ai janë edhe detërat e thella që rrethojnë vendet e largëta, e që janë vetëm pjesë të detit më të madh, që e rrethon tokë nplotësisht. Gjithçka që është zbuluar - shkretëtirat, malet dhe toka, në krahasim me ujin është si një ishull i vogël në një det të madh. E edhe pjesë tjera të tokës janë të mbuluara me ujë. Resulallahu s.a.v.s. ka thënë:

**“Toka në krahasim me detin është sa një torishtë në sipërfaqen e tokës.”**

Pejgamberi e ka krahasuar një torishtë me gjithë tokën, prandaj dije se toka në krahasim me detin edhe është sa një torishtë.

U bëre dëshmitar i mrekullive dhe asaj që ekziston në tokë, e tash mendo për mrekullitë e detërave. Mrekullitë që gjenden aty, gjallesat dhe margaritarët, janë shumë më të mëdha se mrekullitë që i ke dëshmuar në tokë, njëjtë siç është deti shumë më i gjerë se sa toka. Bile në det ka krijesa që nuk gjenden në tokë. Mrekullitë e tyre janë përshkruar nga detarët në libra me vëllime.

Mendo se si Allahu Teala ka krijuar margaritarët, dhe i mbështolli në guaca nën ujë. Shih si rriten perlat nga guri i fortë nën ujë. E mendo edhe për gjëra tjera, për qelibarin dhe aroma të ndryshme që fshihen në det, dhe nga aty nxirren.

Më pas shih habinë e anijeve, se si Allahu Teala bëri që ato të qëndrojnë në sipërfaqen e ujit, e me to lundrojnë tregtarët, ata që donë pasuri, e të tjerët. Anijet u janë nënshtruar, që t’ju bartin barrat. Pastaj dërgohet era që t’a lëvizë anijen, e detarët mësojnë se si krijohen erërat dhe kur fryejnë. Me kapituj të tërë nuk mund të përshkruhen mrekullitë të cilat Allahu Teala ia dhuroi detit.



E nga e gjithë kjo, më e habitshmja është ajo më e zakonshmja - pika e ujit. Ajo është një krijim i ndjeshëm, i vogël, i tejdukshëm, i përbërë nga pjesë, secila e ngjashme me tërësinë e tyre. Është strukturë e sofistikuar, e që shpejt ndahet në dysh, i nënshtrohet ndryshimeve, e pranon edhe bashkimin edhe ndarjen. Në të është jeta e gjithçkaje që gjendet në tokë, e kafshëve dhe bimëve. Nëse robit i pihet ujë e nuk mundet ta gjejë, do të harxhonte gjithë thesarin në botë, gjithë pasuritë e dynjallëkut, që ta marrë ujin. E kur ta pijë ujin, por i pamundësohet ta hedhë atë jashtë nga vetja, do të harxhonte gjithë thesarin në botë, gjithë pasuritë e dynjallëkut, që ta hedh jashtë. Të habisin bijtë e Ademit a.s., sa lartë e vlerësojnë arin, argjendin e margaritarët, e janë të pavëmendshëm karshi mirësive të Allahut Teala, konkretisht, karshi pirjes së ujit kur të jenë etur, kur janë të gatshëm të hargjojnë gjithë çka kanë, vetëm që të kenë ujë.

Mendo pra për mrekullitë e ujit, lumenjëve, puseve dhe detërave. Për to dhe qëllimet e tyre mund të mendohet pafundësisht. Të gjitha ato janë dëshmitarë të qartë dhe shenja ndihmuese, që me gjuhën e gjendjes lajmërojnë për urtësinë dhe madhështinë e Krijuesit të tyre. Ato, me këngën e tyre thërrasin atë që e kupton hakikatin me zemër, duke i thënë: *'A nuk më sheh? A nuk e sheh formën time, strukturën, cilësitë dhe dobinë time, tiparet e ndryshme, vlerat e mia të shumta? Mos po mendon se unë vet e kam krijuar veten, ose më ka krijuar dikush i ngjashëm me mua? A nuk turpërohesh që, kur sheh një fjalë të shkruar me tri shkronja, krijim i njeriut, ti e zmadhon në zemrën tënde atë personi të*

*dijshëm, të aftë e me shprehje të mira, e më pas shikon mrekullitë e shkruara në fletët e fytyrës sime me penën e fuqisë, dhe harron madhështinë e Krijuesit? A nuk turpërohesh?’*

Më pas flet me gjuhën e gjendjes edhe pika e farës (*nutfa*), i flet atij që mund të dëgjojë dhe të kuptojë me zemër: *‘Më paramendo në thellësitë e mitrës, të mbështjellur me gjak të menstruacioneve; në kohën kur lajmërohen linjat dhe format në fytyrën time, e Skulptori m’i formëson bebëzat dhe kapakët e syrit, ballin, faqet, buzët. Dhe i sheh lakesat se si paraqiten njëra pas tjetrës, me ngadalë.’*

E ti nuk sheh as atë që qëndiset në brendësi të farës, as jashtë saj, as nuk sheh në brendësi të mitrës, as jashtë saj. Për atë qfarë ndodh me farën nuk dinë gjë as nëna, as babai, as vet fara, e as mitra. A nuk është një formësim i tillë më i habitshëm se ajo që krijon pena që ti e sheh - skica të ndryshme. Nëse i shikon ato skica dy-tri herë, do të mësosh edhe vet t’i vizatosh. Por a mund të mësosh këtë lloj shkrimi dhe formësimi që përfshinë formësimin dhe shkrimin edhe të së jashtmes edhe të së brendshmes së pikës, dhe të gjithë pjesëve të saj, pa prekjen e pikës, lidhjes me të, as me brendësinë as me të jashtmen e saj?

Nëse të gjitha këto mrekulli nuk të shkaktojnë habi, atëherë habitu si nuk po habitesh! Kjo është në fakt habia e të gjitha habive, prandaj habitu me verbërinë tënde ndaj gjithë këtij hakikati!

Pra, lavdëruar qoftë Ai që jep udhëzim dhe që lë në mashtrim, i Cili dërgon në rrugë të gabuar dhe udhëzon në rrugë të drejtë, i Cili sjellë edhe fatkeqësinë, edhe lumturinë; Ai i cili ia hap basiretin atyre që Ai i do, e këta e dëshmojnë në të gjithë Ekzistencën, dhe në të gjitha anët e botës, dhe i Cili i verbëron zemrat e armiqve të Tij, dhefshihet nga ta me fuqinë e Tij dhe lartësimin e Tij! Atij i takon secili krijim dhe përcaktim. Gjykimi i Tij është absolut, vendimi i Tij nuk ndryshon.

Një nga veprat e Tij është edhe atmosfera, një masë ajri që mbështjell Tokën. Nuk mund të ndjehet me shqisën e të prekurit, e as që mund të shihet me sy. I tëri është si një det unik. Zogjtë janë të lidhur me ajrin, notojnë nëpër ajër me ndihmën e krahëve, njëjtë siç notojnë kafshët e detit në ujë. Ajri i rrotullon ijet dhe anët e veta derisa era fryn, njëjtë siç lëvizin valët e detit. E kur Allahu Teala e nis ajrin, dhe e shndërron në erë që fryn, nëse Ai do, bën që ajo erë të paraqesë lumturi, si lajmëtare e mëshirës së Tij, tamam siç thotë Allahu Teala:

**“Ne i dërgojmë erërat për pllenim.”**

15-Hixhr: 22

Kështu, melëvizje, shpirti i ajrit arrin deri te kafshët dhe bimët, dhe u ndihmon të zhvillohen. E nëse do Allahu Teala, ajrin në formën e erës e kthen në dënim për kryengritjen e krijesave të Tij:

**“Ne u dërguam atyre në një ditë fatkeqe një erë të stuhishme të pandërprerë,**

**e cila i nxirrte njerëzit, sikur të ishin trungje të shkulura hurmash.”** 54-Kamer: 19-20

Shih sa i lehtë është ajri, e pastaj shih ashpërsinë dhe fuqinë e tij kur të ngjeshet në ujë. Vorbulli e kap njeriun e fuqishëm, e bartë, do ta fundosë në ujë, e ky nuk mund të mbrohet. Edhe hekuri i fortë vendoset në sipërfaqen e ujit, dhe fundoset. E ti mendo se si ajri e ngërthen fuqishëm ujin, ani pse vet është aq i butë. Me këtë urtësi Allahu Teala i mbanë anijet në sipërfaqen e ujit. Kështu, çfarëdo objekti i zbrazët, brenda të cilit ka ajër, nuk fundoset në ujë, sepse ajri nuk ndahet nga sipërfaqja e brendshme e anijes. Në atë mënyrë, anija, përkundër peshës dhe forcës, mbetet e lidhur me ajrin e hollë. Kjo është si puna e atij që rrëshqet në pus, por kapet përdorën e tjetrit e kështu nuk bie në fund të pusit. Anija me zbrazëtinë e saj kapet për ajri, dhe kështu mbrohet nga rënja dhe fundosja. Lavdëruar qoftë Ai që një mjet të rëndë transporti e lidhi me ajrin e butë (latif), lidhje kjo që as nuk vërehet! Më pas vrojto mrekullitë e ajrit në qiell dhe retë në të, bubullimën, vetëtimën, shiun, borën, meteoret. Ato janë mrekulli në mes të qiejve dhe Tokës.

Kur’ani Kerim tregon shkurtimisht për të gjitha këto:

**“Ne nuk i kemi krijuar qiejt, Tokën dhe çfarë gjendet midis tyre, për t’u zbavitur!”** 44-Duhan: 38

e në ajetin tjetër jep më shumë hollësira:

**“...reve të nënshtruara lëvizjeve në mes qiellit e Tokës.”** 2-Bekare: 164

Këtu flitet për retë, bubullimën, vetëtimën e shiun, por nëse ty të mjafton vetëm ta shohësh shiun dhe ta dëgjosh bubullimën, e nuk mendon rreth tyre - edhe kafsha është e aftë për këtë.

Atëherë ngritu nga ajo botë e ulët shtazore drejt botës më të lartë (*Mele-i A'la*)! Tani ti i ke hapur sytë dhe ke parë të jashtmen e botës - mbylli sytë fizikë e shih me syrin e zemrës, që të shohësh mrekullitë e brendshme dhe fshehtësitë e pazakonta. Edhe shpjegimi për këtë temë do të tejzgjatej dhe është një derë e pafund.

Mendo për retë e dendura dhe të errëta, ti e vëren se si ato tubohen në qiellin e pastër, ku nuk ka turbullira. Dhe si i krijon Allahu Teala ato, ku të dojë dhe kur të dojë. Me gjithë butësinë e tyre, ato ré bartin ujin me peshë, dhe ndalojnë në shpatijet qiellore, deri sa Allahu Teala të jap leje për rënien e shiut. Lëshimi i secilës pikë ndodh përshtatshëm përcaktimit, ashtu siç do Allahu Teala, në mënyrën që Ai dëshiron. Dhe ti i sheh retë se si lëshojnë ujë në Tokë, duke i lëshuar pikat veç e veç, asnjëra pikë nuk prek tjetrën, e as nuk bashkohen mes vete. Secila lëshohet në rrugën që i është caktuar, pa ndryshuar drejtim. As nuk vonohet ndonjëra, e as nuk bjen para kohe, dhe binë në tokë të gjitha, pikë për pikë. Sikur të mblidheshin të gjitha gjeneratat, të parat dhe të fundit, me qëllim që të krijojnë vetëm një pikë shiu, ose që të numërojnë të gjitha pikat e rëna vetëm në një qytet, të gjithë njerëzit dhe xhinët së bashku, nuk do t'ia arrinin qëllimit. Numrin e pikave e di vetëm Ai që i ka krijuar. Më pas, secila pikë është e lidhur me një pjesë të tokës. Dhe secilës gjallesë, zogjve, bishave të egra, të gjitha insekteve dhe zvarranikëve,

i është caktuar pika që i takon, me përcaktimin e Allahut. Me shqisa fizike nuk mund të dallohet se si një pikë i është caktuar pikërisht një gjallese, në ndonjë mal, që ajo ta arrijë kur ndjen etje, në kohën e caktuar. E ku është tek lidhja mes acarit të ashpër dhe ujit të butë në strukturën e borës, si copë pambuku?!

Është e pamundur të numërohen të gjitha mrekullitë. Të gjitha këto janë bereqete, dhuratë nga i Pushtetshmi (*el-Xhebbar*), i Fuqishmi (*el-Kadir*), dhe nënshtrim i dhënë nga Krijuesi i Vetëm (*el-Hallak*), Ai të Cilit gjithçka i nënshtrohet (*el-Kahir*). Në këtë nuk ka ortak, e as ndonjë pjesëmarrje nga krijesat.

Besimtarët kur shohin të gjitha këto përulën me nderim të thellë ndaj fuqisë dhe Madhësisë së Tij. Kurse të verbërit shpirtëror, të cilët mohojnë, mund të kenë vetëm padituri lidhur me këto bereqete. Ata tërheqin mbi vete mallkimin, duke hamendur për arsyet dhe qëllimin e rënies së shiut. I padijshmi i devijuar do të thotë: *'Shiu bie, pasi që ai prej natyrës është i lehtë. Kjo është arsyeja pse bie shiu'*, dhe i gëzohet *'zbulimit'* të vet. E sikur dikush ta pyeste: *'Çka nënkupton kjo 'natyra', dhe kush e ka krijuar? Kush e krijoi ujin me peshë, dhe si ndodh që ai lëshohet poshtë e prapë ngjitet lartë në zgavrat e trungjeve, pjesë-pjesë? Kjo as nuk mund të shihet e as të dëshmohet, por prapë, a nuk arrin uji deri te secila pjesë e secilit gjeth?'*, ai nuk do ta dinte përgjigjen.

Uji ushqen secilën pjesë të secilit gjeth, dhe udhëton nëpër zgavra, nëpër tejsit e vegjël me qime. Më pas, një tejsë, baza e gjethit, e bartë ujin, nga ajo tejsë e madhe e zgjatur në atë gjeth, deri te tejsit e vegjël. Ajo tejsë e madhe sikur është një lum, e tejsit

tjerë që degëzohen nga aty, sikur të jenë përrocka. Nga përrockat, rrugëtimi i ujit degëzohet deri te tejziti më të vegjël. Më pas zgjerohet, duke krijuar shtigje të rrjetëzuara, mu sikur rrjeti i merimangës, aq të holla sa që nuk mund të shihen me sy, dhe vazhdon kështu deri sa të arrijë në secilën pjesë të gjethit. E ushqen, e nxit që të zhvillohet, e zbukuron, dhe i dhuron lagështinë dhe freskinë e vet. Në të njëjtën mënyrë uji mbërrin te secila pjesë e frytit. Prandaj, nëse uji bie poshtë sepse *“prej natyrës është i lehtë”*, atëherë, si ngjitet lartë? Nëse diçka e tërhjekë, kush ia dha atë cilësi? Nëse në fund thua *Allahu*, pse atëherë që nga filimi nuk pranove se kjo është fuqi hyjnore? Gjendja e fundit e të padijshmit, është gjendja e parë e të zgjuarit.

Hakikati, të fshehtat qiellore dhe yjet janë krijesë e Tij. Ato janë një tërësi. Kush shikon këtë tërësi, nëse nuk ka kuptuar një nga mrekullitë qiellore, sikur të mos ketë kuptuar asgjë, sepse gjithçka tjetër: Toka, detërat, ajri, dhe e gjithë materia, janë në krahasim me qiellin sikur një pikë ujë, bile edhe më të vegjël.

Shih se si Allahu Teala u dha rëndësi të madhe qiejve dhe yjeve në Kur’ani Kerim duke u betuar në to:

**“Betohem në qiellin me plot yje.”**

85-Buruxhë:1

**“Betohem në qiellin dhe yllin e natës.”**

86-Tarik:1

**“Betohem në qiellin me plot rrugë.”**

51-Dharijat:7

**“Betohem në qiellin dhe në Atë që e ka ndërtuar!”** 91-Shems: 5,

ose fjalët:

**“Betohem në Diellin dhe dritën e tij,  
dhe Hënën që e përcjellë  
dhe ditën që e bën të dukshëm atë.”**

91-Shems: 1-3,

ose këto fjalë të Allahut Teala:

**“Betohem fuqimisht në yjet që tërhiqen (ditën, e ndriçojnë natën).”** 81-Tekvir: 15

**“Betohem në yllin kur perëndon.”**53-Nexhm: 1

**“Betohem në çastin e perëndimit të yjeve,  
e ky është betim i madh, sikur ta dini.”**

56- Vakia: 75-76

Ke kuptuar më parë se si të gjitha të fshehtat e një pike të ndotur të farës nuk mund t’i kuptojnë as të gjitha gjeneratat së bashku, të parat dhe të fundit. Por Allahu Teala megjithatë nuk betohet në të. E, çka mendon për atë në çka Allahu betohet! Qiejve ju la furnizimin (riskun) e njerëzve, dhe thotë:

**“Në qiell është furnizimi juaj dhe gjithçka që ju është premtuar.”** 51-Dharijat: 22,  
dhe duke lavdëruar ata që rreth kësaj mendojnë, thotë:

**“...thellohen në mendime rreth krijimit të qiejve e të tokës..”** 3-Ali Imran: 191.



E Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

**“Sa keq për atë i cili e lexon këtë ajet e nuk mendon.”**

Edhe Allahu Teala duke qortuar ata që nuk mendojnë, thotë:

**“Qiellin ua kemi bërë kulm të sigurtë, por ata zbrapsen prej atyre argumenteve.”** 21-Enbija: 32

E si atëherë të krahasohen me qiejt Toka dhe të gjithë detërat, kur Toka dhe detërat në çdo çast ndryshojnë, e qiejt nuk pësojnë ndryshime, deri në kijamet. Për këtë Allahu Teala thotë:

**“Qiellin ua kemi bërë kulm të sigurt.”,**

dhe gjithashtu thotë:

**“Mbi ju kemi ndërtuar shtatë qiej të fortë.”**

78-Nebe: 12

si edhe:

**“A është më i rëndë krijimi juaj apo ai i qiellit?E Ai e ngriti atë!**

**Ngriti kupën e tij dhe e përsosi atë! “**

79-Nazi’at: 27-28

Shiko botën e melekutit, nëse dëshiron të shohësh Madhështi dhe Fuqi që meriton mahninë. Por ky shikim nuk mund të jetë sikur shikimi i kafshës, ose sikur shikimi yt i yjeve a i shiut. Po të ishte dëshiruar vetëm ky shikim, Allahu Teala nuk do ta kishte lavdëruar Ibrahimin a.s.:

**“E kështu Ibrahimit ia mundësua të shohë melekutin e qiejve e të tokës për t'u bërë edhe më i bindur.”** 6-En’am: 75

Çdogjë që shihet me syrin fizik Kur'ani Kerim e quan *alemi shehadet* (bota e dukshme, materia), dhe çdo gjë që nuk shihet me sy, Kur'ani e quan *alemi melekut* (bota melekut) dhe *gajb* (fshehje). Pra, duke thënë: **“Ibrahimit ia mundësuam t'i shohë melekutin e qiejve e të tokës”**, synohet bota që nuk shihet me sy. Aftësia qëndron në mendimin për të, jo që ajo të shihet. Allahu Teala është Krijuesi dhe Mbizotëruesi i botës së fshehur dhe botës së dukshme, materies. Ai është i Gjithëdijshëm për të dy botët. Askush nuk mund ta kuptojë diturinë e Tij, përpos kujt Allahu i dhuron; Ai është i vetmi që e di gajbin (të fshehtën), e këtë ia zbulon vetëm ndonjë të dërguari që Ai do:

**“Ai është që e di të fshehtën, por fshehtësinë e vet nuk ia zbulon askujt.**

**Me përjashtim të ndonjë të dërguari që Ai do.”**

72-el Xhin: 26, 27

Prandaj drejto *mendimin* tënd kah bota e melekutit, o ti i privilegjuar! Në past dhënë Allahu, të hapen dyerte fshehtësisë qiellore, e me zemrën tënde fluturon në pafundësitë e saj, dhe ngritesh deri Arshi Azam. Shpresa është që të ngritesh deri në gradën e pohimit të Omer b. El- Hatabit *“Zemra ime e pa Rabbin tim.”* Sepse e largëta arrihet duke kapërcyer atë që është afër. E për ty, më së afërti është vetja jote (nefs), pastaj Toka - vendqëndrimi yt, pastaj atmosfera që të rrethon. Pastaj janë bimët dhe kafshët, krijesat e gjalla dhe jo të gjalla, e krejt këto janë në sipërfaqen e Tokës. Pastaj të fshehtat mes Tokës dhe qiejve, e më pas edhe të shtatë qiejt me yjet e tyre. Pastaj *Kursi-a*, *Arshi*, dhe melaqet që e bartin Arshin dhe i ruajnë thesaret qiellore; e kur të

gjitha këto i lë prapa, atëherë vie radha e Rabbit të të gjitha këtyre dhe Arshit. E ti, ani pse nuk e ke tejkaluar as më të afërtën, njohjen e të jashtmes tënde, paturpësisht flet për njëfarë njohjeje të Rabbit tënd, e thua: *“Unë e njoh Rabbin tim, njoh krijesat e Tij.”*! Çfarë je duke bërë?! Për çfarë mendon ti?!

Ngrite kokën tënde tash kah qielli! Shihe qiellin, shih yjet! Vrojto lëvizjet e tyre, ndriçimin, orbitën e tyre! Shih tash diellin dhe hënën, lindjen dhe perëndimi e tyre. Zellin e tyre për rrotullim të përhershëm, pa kurfarë shenje për ndalesë në lëvizje, dhe pa kurfarë ndërrimi të rrugës. Gjithçka lundron në rrugën e vet, përshtatshëm caktimit - asgjë nuk shtohet a pakësohet, derinë kijamet. Mendo mirë për numrin e yjeve në qiell, shumësinë e tyre dhe llojllojshmërinë e ngjyrave.

Pastaj shih format e tyre, disa në formë akrepi, të tjerat në formë të dashit a të kaut, të luanit a të njeriut. Secila formë që mund të gjendet në Tokë mund të gjendet edhe në qiell. Shih pastaj lëvizjen e diellit në orbitën e tij, në kohëzgjatje prej një viti. Po të mos kishte lindje dhe perëndim të diellit, nuk do të dallonin nata me ditën. Nuk do t'i dallonim kohët; do të ishte gjithmonë errësirë ose gjithmonë ditë, e nuk do të dinim se kur është koha për të fjetur e kur për të punuar. Shih si ka dhënë Allahu Teala natën si perde, gjumin si pushim, e ditën për veprim. Vrojto se si Allahu Teala natën e vesh me ditë, e ditën me natë, dhe i zgjatë e shkurton, krejt në kohë të caktuar. Shih se di dielli ndryshe pozicionohet në krahasim me mesin e qiellit, e me këtë bëhet dallimi

mes katër stinëve. Kur dielli lëshohet më poshtë se mesi i qiellit, ajri ftohet dhe vie dimri. E kur dielli lartësohet në qiell, forcohet të nxehtit. Nëse dielli është në mes të këtyre dy pozitave, periudha kohore barazohet. Është e pamundur të kuptohet bile edhe një e dhjeta pjesë e të gjitha gjendjeve të mahnitshme të qiellit. Tregimi ynë është vetëm për të shpjeguar rrugët e mendimit.

Edhe këtë dije mirë që, në krijimin e çdo ylli, në formën, ngjyrën dhe vendosjen e tij në vend të caktuar, ka urtësi (hikmet) të panumërta të Allahut Teala. Edhe me organet e trupit është njëjtë - në çdo pjesë të secilit organ, dhe në çdo vendosje të caktuar ka urtësi të panumërta. E qiejt janë më të rëndësishëm se këto.

Toka nuk mund të krahasohet me qiellin assesi, as me madhësi e as me numrin e kuptimeve. Dallimi shihet edhe në madhësi mes tyre. Njëzëri është pranuar se dielli është mbi njëqind e gjashtëdhjetë herë më i madh se Toka. Edhe ylli, më i vogli mes tyre, është tetë herë më i madh. Ka edhe yll që është njëqind e njëzet herë më i madh. Me këtë kuptohet se sa larg janë. Allahu Teala, duke vënë shenjë në këtë largësi thotë:

**“Lart e ka ngritur kupën e tij dhe e ka përsosur.”** 79-Naziat: 28

Thuhet se mes secilit qiell ka nga pesëqind vite distancë. E kur vëllimi i një ylli është më i madh se Toka, paramendoji të gjitha yjet, e më pas qiejt ku ato yje janë të vendosur, sa i madh duhet të jetë i gjithë qielli! Drejto vëmendjen më pas në shpejtësinë

e lëvizjes së Tokës, që është aq e shpejtë sa ti as nuk e vëren. Resulallahu s.a.v.s., e pyti Xhebrailin a.s.,

- **A perëndoi dielli?** Xhebraili a.s., tha:

- *Jo, po.* Resulallahu s.a.v.s., e pyeti:

- **Çfarë përgjigje është kjo?** Xhebraili a.s., tha:

- *Prej momentit kur thashë 'jo', e deri sa thash 'po', Dielli e kaloi rrugën prej 500 vjetësh."*

Mendo për madhësinë e Diellit, dhe rrugëtimin e tij. E pastaj mendo fuqinë e Krijuesit të tij, se si bëri që forma e Diellit, me gjithë hapësirat e gjera të tij, të mund të futet në bebëzën e syrit, prandaj ulesh këtu në Tokë, i hap sytë, shikon kah Dielli, dhe e sheh në tërësi. E këta qiej, me madhësitë e tyre dhe shumësinë e yjeve që bartin - mos i shiko ato, por mendo për Krijuesin e tyre; si i krijoi të gjitha, pastaj si i mban të mos bien, pa kurfarë shtyllash të dukshme, pa kurfarë lidhje të dukshme me diçka tjetër. Gjithë bota është si një shtëpi, e qiejt janë si mbulesa të saj.

Ti habitesh kur hyn në shtëpi të ndonjë të pasuri, dhe menjëherë vëren luksin e zbukurimeve të saj, veshjen me ar, nuk ndalesh së habituri. Vazhdimisht flet për të, gjithë jetën përshkruan bukurinë e asaj që një herë ke parë. Kurse gjithë kohën e sheh këtë *shtëpi madhështore* (gjithësinë), tokën e saj, mbulesën, bukuritë e saj, mrekullinë e gjallërive në të, zbukurime mahnitëse. Megjithatë, për këtë nuk tregon, zemra nuk të lidhet për të. Ku është kjo *shtëpi*, e ku ajo që ti vazhdimisht e përshkruan. Ajo shtëpi me të cilën ti je mahnitur është një prej pjesëve më pavlerë të kësaj Toke, e vet

Toka, është vetëm një pjesë e vogël e *shtëpisë madhështore - gjithësisë*.

Megjithëkëtë, i vetmi shkak i mos-shikimit tënd në këtë gjithësi është se Rabbi yt e ka ndërtuar atë. E ti e ke harruar veten, Rabbin tënd, shtëpinë e Rabbit tënd.

Je i zënë me barkun tënd, të interesojnë vetëm epshet, ti nuk ke synim tjetër veç se epshet dhe lavdërimi. E gjithë dëshira jote është të mbushësh barkun, anuk mund të hash as sa e dhjeta pjesë e asaj që hanë kafshët. Pra, edhe këtu kafsha është dhjetë herë më lartë se ti! Kurse dëshira jote për lavdërim janë dhjetë ose njëqind të njohur, që para teje bëhen lajkatarrë e në vete fshehin armiqësi ndaj teje. Edhe po të jenë të singertë në miqësi ndaj teje, ata nuk mund t'i bëjnë dobi as dëm, as vetes as ty, as të sjellin vdekjen, as jetën, as ringjalljen.

Afër teje ka shumë hebrej dhe të krishterë të pasur, pozitën e të cilëve ti e lakmon. Plotësisht je i preokupuar me këtë mashtrim, dhe plotësisht i pavëmendshëm për bukuritë qiellore dhe të botës.

Shembulli yt është si një milingonë që ka bërë fole në pallatin e mbretit, pallat ky i ngritur lartë, i mahnitshëm, i zbukuruar me shërbëtorë, me plot hijeshi e vlera. E kur të dalë milingona nga ajo fole e saj e të takojë ndonjë mik të vetin, do t'i tregonte atij për folenë, të mbushur me furnizime që milingona i ka mbledhur. Kurse për vet pallatin e mahnitshëm, të zbukuruar me shërbëtorë, me plot hijeshi e vlera, milingona as që mendon.

Siç është milingona e pavëmendshme ndaj pallatit të mahnitshëm ku ka bërë fole, si edhe ndaj banorëve të tjerë të atij pallati, as ti nuk di gjë për qiellin, nuk di asgjë për melaqet e qiejve. I njëjtë je si milingona. Ashtu është, por milingona nuk ka fuqi të menduarit për ty dhe pallatin tënd, mjeshtërinë e ndërtuesit të saj. E ti, ti e ke aftësinë të ngritesh deri te melekuti qiellor dhe t'i njohësh të fshehtat e tyre.

Do ta ndalim këtu të folurit për këtë temë, sepse kjo vazhdon të rrjedhë, nuk ka fund. Sikur edhe gjithë jetën të flasim për këtë, nuk do të mund të komentojmë të gjitha me çka Allahu Teala na ka begatuar.

Gjithçka që ne kemi njohur është pak, e imët, e parëndësishme, në krahasim me njohurinë që kanë dijetarët dhe evliatë, e ajo njohuri që ata e kanë është pak në krahasim me njohurinë që e kanë Pejgamberët. Ajo që kanë njohur pejgamberët a.s., është pak në krahasim me atë që kanë njohur melekët më të afërt të Allahut (mukarebun). Kurse gjithë njohja e melaqeve, xhinëve dhe njerëzve, nëse krahasohet me diturinë e Allahut Teala, as nuk mund të quhet dituri. Më parë mund të quhet habi, huti, paplotësi dhe pafuqi. I Lavdëruar qoftë Allahu, që robëve të Tij u dha njohje aq sa ju dha, e më pas iu drejtua të gjithëve:

**“...e juve ju është dhënë fort pak dije.”**

17-Isra: 85

Kjo është një përmbledhje e shpjegimit për ata që dëshirojnë të mendojnë, se duhet të meditojnë për krijesat e Allahut Teala, jo për Dhatin e Tij. Nuk ka aspak dyshim që, duke menduar për krijesat, mund të mësohet edhe për Krijuesin, madhështinë dhe fuqinë e Tij. Dhe sa herë që të shtohet habia me krijimet e Allahut Teala, njohja jote e madhështisë dhe fuqisë së Tij është më e plotë. Kjo është sikur pëlqimi i diturisë së një dijetari. Sa më shumë që je i informuar për diturinë dhe shkrimet e tij, po aq të shtohet dashuria dhe respekti yt për të, dhe lidhja jote me të forcohet.

Njëjtë mendo edhe për krijimet e Allahut Teala, renditjen dhe rregullin e veprimit të tyre. Të menduarit për këto nuk përfundon kurrë.

Kësaj mund t'i shtohet edhe ajo që kemi përmendur në detaje në Librin 'Durim dhe Falënderimin' (*kitabu's-sabr dhe kitabu's-shukur*). Aty kemi tërhequr vëmendjen në mirësitë dhe bereqetet e Allahut Teala ndaj nesh. Kurse në këtë libër kemi tërhequr vëmendjen në tefekkurin për krijesat që Allahu Teala i ka krijuar.

Shikimi dhe mendimi ynë për krijesat e Allahut Teala, për mirësitë dhe bereqetet e Tij ndaj nesh, mund të shikohen edhe me sy tjetër nga një natyralist, dhe kjo i bëhet atij shkaktar për devijim dhe egërsi. Ndërsa, kujt Allahu Teala i mundëson sukses në shikim dhe mendim rreth këtyre, kjo i bëhet shkak për udhëzim dhe lumturi.



Nuk ka asnjë atom në qiej a në Tokë, e që me të Allahu Teala të mos e largojë dikë nga rruga e drejtë, e dikë ta udhëzojë në rrugë të drejtë. Kush e kupton që këto janë vepra të Allahut Teala, dhuratë prej Tij, do të njohë madhësinë e Allahut Teala, dhe kështu do të udhëzohet. E kush shikon në këto vepra në mënyrë gjysmake, duke menduar që ato kanë ndikim absolut mbi njëra-tjetrën, e jo që janë të lidhura për shkaqe, dhe nuk mendon Krijuesin e shkaqeve, do të devijojë dhe do të shkatërrohet.

Kërkojmë strehim te Allahu Teala nga devijimi, dhe e lusim për bereqetet e Tij, për mirësinë, dhe rahmetin e Tij, dhe që të largojë nga ne hapat e të padijshmit.

Këtu ka përfunduar libri i nëntë, mbi Tefekkurin, nga vëllimi i katërt (*Rub'u'l-Munxhijat*). Falënderimi (hamd) i takon vetëm Allahut. Salat dhe selam Resulallahut s.a.v.s., ehli bejtit dhe as'habëve të tij.

## PËRMBAJTJA

PARATHËNIE .....	3
VLERA E LARTË (FAZILET) E TË MENDUARIT (TEFEKKUR) .....	7
HAKIKATI DHE FRYTET E MENDIMIT .....	15
RRUGËT E MENDIMIT .....	21
PJESA E PARË .....	22
PJESA E DYTË .....	40
TË MENDUARIT RRETH KRIJESAVE TË ALLAHUT .....	43

